



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
“BASHKINË TEPELENË”

RAPORT PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT
“AUDITIM FINANCIAR MBI VEPRIMTARINË E BASHKISË TEPELENË”

TIRANË 2024

Përmbajtja

I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
a.	Përshkrim i shkurtër i institucionit	3
b.	Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.....	3
c.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit:.....	3
d.	Metodat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:.....	4
e.	Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve.....	4
	KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT	5
II.	HYRJE	6
1.	Objektivat dhe qëllimi.....	6
2.	Identifikimi i çështjes:.....	7
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:	7
4.	Përgjegjësia e audituesve të KLSH:.....	7
5.	Kriteret e vlerësimit:	7
6.	Dokumentimi i rezultateve të auditimit:.....	9
III.	PËRSHKRIM I REZULTATEVE SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT	10
1.	AUDITIM MBI KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK.	13
2.	AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT	25
3.	AUDITIM MBI VLERËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR TË ARRITUR NË OPINIONIN NË SE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2022, JAPIN NJË PARAQITJE TË VËRTETË E TË DREJTË TË POZICIONIT FINANCIAR, PERFORMANCËS FINANCIARE DHE FLUKSIT TË PARASË, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQL.	42
4.	AUDITIM MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE MBI ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE (ASETE DHE PYJE E KULLOTA) TË TRASNFERUARA SIPAS VKM.	61
5.	MBI AUDITIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM	63
III.	GJETJE DHE REKOMANDIME	75
A.	MASA ORGANIZATIVE	75
B.	MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.	83
C.	MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE – TË ARDHURA TË MUNGUARA	85
IV.	LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT	Error! Bookmark not defined.
V.	ANEKSE	Error! Bookmark not defined.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit

Tepelena kufizohet në veri me bashkinë Tepelenë, në lindje me bashkinë Këlcyrë, në jug me bashkinë Gjirokastrë dhe në perëndim me bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Tepelenës. Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia ka një popullsi prej 8.949 banorësh. Ndërkohë që sipas Regjistrisë Civile, kjo bashki numëron 16.371 banorë. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 431.24 km² me një densitet prej 12.1 banorë/km² (disafish më e ulët se mesatarja në rang vendi, për shkak të sipërfaqes së madhe me zonë malore). Kjo bashki përbëhet nga 4 njësi administrative. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 24 fshatra. Bashkia e Tepelenës zgjerohet me disa zona rurale, të cilat merren kryesisht me blegtori. Shërbimet e vogla tregtare dhe mbledhja e bimëve medicinale sigurojnë pak të ardhura për familjet. Një nga projektet më të rëndësishme është ai i qendrës së qytetit të Tepelenës, ku synohet edhe rivitalizimi i kalasë së Ali Pashës në funksion të nxitjes së turizmit. Kjo kala, por edhe pasuri të tjera si kanioni i Bënçës, ura e Beçishtit apo Uji i Ftohtë mund të shërbejnë për nxitjen e turizmit kulturor dhe natyror. Ekonomia e Bashkisë Tepelenë karakterizohet nga prezenca e informalitetit dhe mbizotërimi i bizneseve të vogla dhe familjare. Numërohen në total rreth 353 biznese, nga të cilat pjesa më e madhe e zhvillojnë aktivitetin në territorin e njësisë administrative Tepelenë. Struktura organizative aktuale është miratuar me Vendim të Titullarit nr. 7 datë 27.01.2023 dhe numri i punonjësve prej 235 vetash me VKB nr. 95, datë 25.11.2022.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore” nenit 50 “Auditi i jashtëm” pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: *“1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm, 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë”*. Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Tepelenë si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Tepelenë. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit.
- mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2023, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- mbi zbatimin i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

d. Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:

Metodat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit; në procedurat bazë dhe në procedurat analitike pas testimeve të kryera me qëllim arritjen e objektivave të auditimit.

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodatat dhe teknikat e mëposhtme:

Intervistimi - duke marrë informacion nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit dhe atij të përfshirë për një çështje të caktuar, e kombinuar kjo me shqyrtimin e evidencave përkatëse:

Raportet dhe informacione - shfrytëzimi i raporteve/ informacioneve relevante dhe të që kanë lidhje me objektivat e auditimit dhe specifikuat me drejtimet e auditimit;

Verifikimi në sistemin elektronik - me përzgjedhje të çështjeve të veçanta të auditimit, sipas drejtimeve të auditimit;

Të kombinuara, sipas rastit dhe vlerësimit të audituesve.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se Bashkia Tepelenë për periudhën nën auditimit paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat grupi i auditimit ka konstatuar 13 gjetje dhe janë lënë 13 rekomandime.

f. Gjetjet kryesore

- Nivel i lartë i detyrimeve të prapambetura në vlerën 33,874,193 lekë lekë, si pasojë e mos realizimit të të ardhurave.

- Efekt financiar negative/të ardhura të munguara në vlerën 6,535,790 lekë, si dhe detyrime për arkëtim në vlerën 40,728,488 lekë nga mos arkëtimi i detyrimeve nga taksa dhe tarifa vendore.

-Mos pasqyrim i situatës reale në llogaritë kontabël të institucionit si pasojë e

- Në gjendjen prej 153,584,876 lekë të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në mbyllje të vitit 2023 nuk është përfshirë vlera pjesore prej 2,785,790 lekë e pa derdhur nga Ujësjiellës-Kanalizime e taksave dhe tarifave vendore të mbledhura nga taksapaguesit si detyrim i vitit 2023
- Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” në aktiv të bilancit në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 352,003 lekë dhe me kosto historike në vlerën 352,003 lekë. Kjo llogari i përket projektit “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale” vlerë e shtuar gjatë vitit 2022, për të cilën nuk është llogaritur amortizim në masën 15%.
- Nga lista e aseteve të transferuara, rezulton se Bashkia Tepelenë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me certifikatë në ZVRPP Tepelenë 214 asete me sipërfaqe 1,007 ha tokë të llojit pyje, kullota e ara, ose 7.2% të aseteve me vlerë kontabël të paraqitur edhe në bilanc prej 1,161,383,237 lekë. Ndërkohë që janë marra masa dhe është aplikuar për regjistrimin e 83 aseteve të tjera. Nga auditimi konstatohet se veprimet e mësipërme janë kryer vetëm asete të llojit troje, kullota, ara, etj, dhe nuk konstatohet të jenë kryer aplikime apo regjistrime për asetet e llojit objekte.

g. Rekomandimet kryesore

Rekomandimet më kryesore për përmirësimin e situatës lidhen me sistemimet përkatëse në llogaritë kontabël për mangësitë e konstatuara, masat për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, si dhe ato për arkëtimin e debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore si vijon:

- Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Tatimeve mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në

infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet që janë legalizuar

- Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tepelenë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2023.
- Bashkia Tepelenë nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe NJA, të marrë masa për krijimin e regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë “familjare” me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë
- Bashkia Tepelenë për vitin 2024 të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 33,874,193 lekë, përkatësisht 5,528,329 lekë të investimeve nga Bashkia, 28.222.865 lekë nga mallrat dhe shërbimet, 122.999 lekë të vendimeve gjyqësore, duke marrë këto masa: reduktimin e shpenzimeve, rritjen e të ardhurave vendore, mbledhjen e arkëtimin e debitorëve, kërkimin e çeljes së fondeve nga qendra sipas burimit financimit të investimeve të kryera..
- Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të aktiveve afatgjata jo materiale dhe të kryejë sistemimet e kontabël përkatëse në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*”.
- Titullari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura pa regjistruar cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me certifikatë pronësie.

I.1 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinioni i auditimit financiar.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Tepelenë për vitin ushtrimor 2023, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumatat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një ***opinion të pa modifikuar/kualifikuar me theksim të çështjes*** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Tepelenë, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për opinionin e pa modifikuar/kualifikuar me theksim të çështjes”, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2023, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes, janë adresuar disa çështje (jo thelbësore), të cilat paraqiten te paragrafi “Theksimi i Çështjes” dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemimin e tyre.

Baza për opinion:

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 5,601 mijë lekë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2023 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:

“Theksimi i çështjes”

- Në gjendjen prej 153,584,876 lekë të llogarisë 468 “*Debitorë të ndryshëm*” në mbyllje të vitit 2023 nuk është përfshirë vlera pjesore prej 2,785,790 lekë e pa derdhur nga Ujësjetës-Kanalizime e taksave dhe tarifave vendore të mbledhura nga taksapaguesit si detyrim i vitit 2023.

- Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” në aktiv të bilancit në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 352,003 lekë dhe me kosto historike në vlerën 352,003 lekë. Kjo llogari i përket projektit “*Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale*” vlerë e shtuar gjatë vitit 2022, për të cilën nuk është llogaritur amortizim në masën 15%

- Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në 50 raste faturash me vlerë 43,646,548 lekë, *mbi afatin e miratuar 30 ditor të pagesave nga data e faturave* për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Tepelenë.

II. HYRJE

Mbështetur në ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 620/1 Prot, datë 09.05.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 13.05.2024 deri më datë 06.06.2024 në subjektin Bashkia Tepelenë, u krye auditimi financiar për periudhën 01.01.2023 deri 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. R. K., Përgjegjës grupi
2. I. Sh., Audituese
3. E. K., Audituese
4. K. F., Audituese

1. Objektivat dhe qëllimi

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2023, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

2. Identifikimi i çështjes:

Raporti i auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit dhe të përgjegjësive të titullarëve dhe stafëve mbështetëse për realizimin e përgjegjësive publike.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, çështjet e vlerësuara i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, në funksion të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë së këtij institucioni publik, transparencës, përgjegjësisë dhe logaritdhënies.

Raporti i auditimit është i strukturuar në disa kapituj ku identifikohet hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimin e auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të audituesve, kriteret, përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprind një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej drejtimeve të auditimit; përfshirë dhe gjetjet e rekomandimet së bashku me anekset.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Titullari i Bashkisë, dhe Nëpunësi Zbatues sipas rastit, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, etj. Gjithashtu, stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

4. Përgjegjësia e audituesve të KLSH:

Përgjegjësia e audituesve është dhënia e opinionit mbi problematikat e trajtuara të çështjeve nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI. Këto standarde kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, si dhe të planifikojë e kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar me objekt: dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord. Objektivi ynë lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Bashkisë, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Gjatë kryerjes së auditimit, audituesit e KLSH marrin evidenca të besueshme, të përshtatshme dhe të mjaftueshme për të mbështetur gjykimin dhe konkluzionet e dala lidhur me organizimin, veprimtarinë, programin dhe funksionet e subjekteve nën auditim. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojnë.

5. Kriteret e vlerësimit:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar:

Ligji nr. 24/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

Ligji nr. 84/2023 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që ndryshojnë këtë ligj.

Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”

Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, i ndryshuar;

VKM 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”;

Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për Huamarrjen e Qeverisjes Vendore”;

Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”;

UMFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, etj.;

Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014.

Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”;

Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

Ligji nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, i ndryshuar me ligjin nr. 9477 datë 9.2.2006”;

VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësive që varen prej tyre” i ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001;

VKM nr. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;

VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;

Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar me UMFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.;

Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237, datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar”;

Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Lokale”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për Taksat Kombëtare”, i ndryshuar

VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, me ndryshime;

VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;

Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

6. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Tepelenë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë: - ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”; si dhe ISSAI 4200; - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

7. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël. 4. Kontrolli i vlerësimit Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre. 5. Konfirmim nga të tretët Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

3. Intervistimi

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Tepelenë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

4. Raporte dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

8. Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave dhe dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, si dhe intervistave, takimeve, konsultave dhe komunikimeve me stafin, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të përfundimeve të arritura mbi bazën e programit të auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; arsyetimin pas të gjitha çështjeve të rëndësishme që kërkohet për ushtrimin e gjyqimit profesional, si dhe

konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, intervistave etj., të finalizuara me akt-konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Raporti Auditimi. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e mbledhura gjatë auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur vlerësimet / përfundimet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tij.

III. PËRSHKRIM I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm

Gjetje	Referenca	Rëndësia	Rekomandimi
Nga auditimi rezulton se Bashkia Tepelenë ka patur detyrime të prapambetura në fillim të vitit në vlerën 26,173,384 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime në vlerën 16,879,996 lekë ndërkohë që janë shlyer në vlerën 9,179,187 lekë, duke rezultuar në një detyrim progresiv në fund të 2023 në vlerën 33,874,193 lekë, e cila do të rëndojë në buxhetin e vitit 2024 krahas likuidimeve të radhës.	Pika III.2.2	E lartë	Bashkia Tepelenë për vitin 2024 të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 33,874,193 lekë, përkatësisht 5,528,329 lekë të investimeve nga Bashkia, 28.222.865 lekë nga mallrat dhe shërbimet, 122.999 lekë të vendimeve gjyqësore, duke marrë këto masa: reduktimin e shpenzimeve, rritjen e të ardhurave vendore, mbledhjen e arkëtimit e debitorëve, kërkimin e çeljes së fondeve nga qendra sipas burimit financimit të investimeve të kryera.
Nga auditimi u konstatua se në gjendjen prej 153,584,876 lekë të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023 nuk është përfshirë vlera pjesore prej 2,785,790 lekë e pa derdhur nga Ujësjiellës-Kanalizime e taksave dhe tarifave vendore të mbledhura nga taksapaguesit si detyrim i vitit 2023, pasi ka ardhur shkresa e konfirmim/rakordimit në vitin 2024 pas mbylljes të veprimeve kontabël të vitit ushtrimor.	Pika III.2.3	E mesme	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.
Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në aktiv të bilancit në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 352,003 lekë dhe me kosto historike në vlerën 352,003 lekë. Kjo llogari i përket projektit “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale” vlerë e shtuar gjatë vitit 2022, për të cilën nuk është llogaritur amortizim në masën 15%	Pika III.2.3	E lartë	Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të aktiveve afatgjata jo materiale dhe të kryejë sistemimet e kontabël përkatëse në llogarinë 202 “Studime dhe kërkime”.
Bashkia Tepelenë zotëron në total 2308 asete të kaluara në pronësi me VKM. Nga këto, Bashkia Tepelenë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me çertifikatë në ZVRPP Tepelenë 214	Pika III.2.4	E lartë	Titullari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteve të mbetura

<p>asete me sipërfaqe 1,007 ha tokë të llojit pyje, kullota e ara, të cilat janë kontabilizuar në vlerën prej 1,161,383,237 lekë. Ndërkohë që janë marra masa dhe është aplikuar pranë DVAShK për regjistrimin e 83 aseteve të tjera. Nga auditimi konstatohet se veprimet e mësipërme janë kryer vetëm asete të llojit troje, kullota, ara, etj, dhe nuk konstatohet të jenë kryer aplikime apo regjistrime për asetet e llojit objekte. Gjithashtu konstatohet se për të gjitha asetet që i kanë kaluar në pronësi, Bashkia nuk ka kryer një inventarizim periodik, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre që pas kalimit në pronësi, nëse janë ende ekzistente apo të dëmtuara, të zaptuara rishtazi, privatizuara, etj. Po kështu sa i takon aseteve të llojeve kullota/pyje transferuar sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, rezulton se Bashkisë Tepelenë i janë transferuar asete gjithsej 29’340 ha, nga të cilat 8’950 ha Pyje, 19’989 ha Kullotë dhe 401 ha Toka joproduktive. Nga sipërfaqet e mësipërme rezulton se janë rregjistruar në AShK Tepelenë rreth 29’000 ha.</p>			<p>pa regjistruar të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.</p>
<p>Nga pagesat që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2023 nga 13 objekte të legalizuara me vlerë 278,190 lekë kanë paguar detyrimin 10 subjekte me vlerë 240,278 lekë dhe nuk kanë paguar 3 qytetarë me vlerë 37,912 lekë. Ndërsa nga vitet e mëparshme janë 58 debitorë në vlerë totale 2,059,646 lekë, gjithsej 61 debitorë në vlerë totale 2,097,558 lekë, që përbën detyrim për arkëtim në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.</p>	<p>Pika III.2.2</p>	<p>E lartë</p>	<p>Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Tatim taksave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet që janë legalizuar me vlerë 2,097,558 lekë.</p>
<p>Bashkia Tepelenë nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Tepelenë nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifatat e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Sektori Tatim Taksave regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë nuk ka një regjistër.</p>	<p>Pika III.2.2</p>	<p>E lartë</p>	<p>Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tepelenë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të vitit 2023 në vlerën progresive 22,233,772 lekë e përbërë nga: - Detyrimet nga taksat dhe tarifatat për 184 subjekte biznes i vogël në shumën 599,060 lekë; - Detyrimet nga taksat dhe tarifatat për 49 subjekte biznes i</p>

<p>Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitore dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë. Gjendja e debitorëve progresiv të vitit 2022 është 20,381,318 lekë dhe në fund të vitit 2023 vlera debitorëve është 22,233,772 lekë.</p>			<p>madh në shumën 11,536,571 lekë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Detyrime nga 6 institucione në shumën 769,648 lekë; - Detyrime nga Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi në 3 raste në shumën 10,313,690 lekë; - Detyrime nga NJ.A. Qendër në shumën 9,328,493 lekë. <p><i>a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.</i></p> <p><i>b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).</i></p> <p><i>c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim pagesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.</i></p> <p><i>d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.</i></p> <p><i>e-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Tepelenë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.</i></p> <p><i>f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.</i></p>
<p>Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 6 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, të 6 subjektet kanë detyrime me një efekt financiar me vlerë totale 3,750,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.</p>	<p>Pika III.2.2</p>	<p>E lartë</p>	<p>Bashkia Tepelenë, Sektori i Tatim Taksave të marrë masa që subjektet të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar</p>

			detyrimet ndaj Bashkisë Tepelenë me vlerë 3,750,000 lekë. Gjithashtu, Sektori i Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.
--	--	--	--

2. Përshkrimi sipas drejtimeve të auditimit

1. AUDITIM MBI KONTROLLIN E BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Tepelenë ka Kod të Etikës, miratuar me vendimin nr.4 ,datë 13.01.2023,ku janë përcaktuar veprimet që parandalohen në kapitulli II “Etika dhe sjellja etike”, kapitulli III “Etika e paraqitjes” dhe të gjitha detyrimet dhe normat e sjelljes. Ndërsa në kapitullin “Sanksionet” për procedurat disiplinore për shkeljen e rregullave të etikës së shërbimit civil, mos plotësim të detyrave, thyerjes së disiplinës si dhe rastet e tjera të parashikuar nga ligji 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në të cilat përcaktohen parimet që duhet të respektojë cdo punonjës në punën e tij, si dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion. Njohja e stafit me rregulloren dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, por nuk ka trajnime për këto raste.

- Për procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, janë hartuar rregullore, ku një rregullore nr.156 me datë 27.11.2017 “Për hetimin administrativ të sinjalizimit dhe mbrojtjen e konfidencialitetit në Bashkinë Tepelenë” dhe rregulloren nr.82/1, datë 24.12.2019 “Rregullore për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në Bashkinë Tepelenë”.Gjithashtu në rregulloren e brendshme neni nr.25 është përcaktuar procedura për sinjalizimin.

Në të cilat janë përcaktuar veprimet që parandalohen, ndëshkimin e rasteve, procedurat e masave disiplinore të parashikuara në legjisllacionin për Shërbimin Civil dhe Kodin e Punës. Për shkeljet e administrative në lidhje me ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit publik”, në nenin 20 të Rregullores së Brendshme, janë parashikuar përgjegjësia administrative dhe detyrat e koordinatorit të së drejtës për informim. Për cdo vit është hartuar raporti i Njesisë përgjegjëse për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, me shkresat përkatëse, depozituar pranë Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit të Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të interesave (ILDKPKI). Nga testimi rezultoi se nuk ka patur raste të raportuara të shkeljeve të kodit etik.Nuk ka programe të trajnimit për integritetin dhe sjelljen, por në vitin 2020, punonjës të Bashkisë Tepelenë kanë marrë pjesë në trajnime online për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve .

- Ankesat nga jashtë mund të depozitohen zyrtarisht pranë institucionit (zyrën e protokollit), zyrës me një ndalesë dhe koordinatorit të informimit publik, duke iu adresuar Kryetarit të Bashkisë, këto struktura janë të përcaktuara, në nenet 20 (koordinatori publik) , neni 35/26 (zyra me një ndalesë) dhe neni 35/22 zyra e protokollit të Rregullores së Brendshme.

-Ka proces vlerësimi për punonjësit që kanë lidhur marrdhëniet e punës në bazë të shërbimit civil sipas formularit tip dhe një herë në vit.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikqyrje”

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikqyrëse, që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të tij.

-Nga Drejtoritë dhe Sektorët janë hartuar planet vjetore dhe mujore të punës dhe raportet vjetore të analizës së veprimtarisë drejtuar Titullarit (NA) dhe Këshillit Bashkiak lidhur me realizimin e objektivave të miratuara sipas programeve. Në Rregulloren e Brendshme, në detyrat dhe përgjegjësitë e të gjitha niveleve janë përcaktuar mënyra e e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA drejtuar Nënkryetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë. Ky rregull jo gjithmonë është ndjekur për periudhë mujore, por raportimi është realizuar për periudha 3-mujore e 6-mujore. Mungon dokumentimi i takimeve të menaxherëve me stafine lartë menaxherial.Ndërsa për çdo mbledhje të titullarit me stafin për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse janë mbajtur procesverbale.

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga Shoqëria Rajonale e UK sha Gjirokastër ,Bashkia merr raportime në lidhje me vendim-marrjen këshillit drejtues, pasi bashkia është një nga aksionerët, por mungojnë raportimet periodike për performancën e veprimtarisë dhe risqet kryesore lidhur me objektivat, përveç raportimeve financiare për efekt mbledhjes së të ardhurave.

-Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese,Njësia e Harmonizimit në MFE si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari /NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

-Është hartuar Rregullorja e Brendshme e organizimit dhe funksionimit të Bashkisë Tepelenë me Vendimin e Kryetarit nr.08 datë 27.01.2023 dhe ka një ndarje të detyrave dhe funksioneve

-Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit,si dhe plan veprimet e menaxhimit të financave,të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

-Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kane marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve),për të cilat janë mbajtur procesverbale të takimeve të tyre, apo procesverbale të tryezave të rumbullakëta me palët e treta si me grupet e interesit,si dhe për dëgjesat me publikun.

-Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

-Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri njëfarë mase, Mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të IT.

-Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë, me Vendim të Kryetarit nr.7 datë 27.01.2023 “Për miratimin e

strukturës, organizative të Bashkisë Tepelenë 2023” Numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 95 datë 25.11.2022, me 235+2 punonjës të miratuar dhe strukturë: Kabineti, 6 Drejtori, 16 Sektorë, 3 NJA.

-Në Rregulloren e Brendshme janë përfshirë baza ligjore, që i përket gjithë fushave të veprimtarisë saj. Për çdo Drejtori janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë sipas hierarkisë në nivel drejtori, përgjegjës sektori dhe specialist, si dhe janë përcaktuar objektivat për secilën drejtori sipas funksioneve që ato mbulojnë.

Në Bashkinë Tepelenë, funksionin shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht funksionojnë sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike, sipas rregullores së brendshme. Mënyra e shkëmbimit të informacionit dokumentar dhe elektronik është përcaktuar në pjesë të veçanta të Rregullores së Brendshme të Bashkisë Tepelenë, nenet 21-22 nenet 28-29 dhe kreu VI “Administrata e Bashkisë”. Kanë funksionuar linjat e komunikimit të jashtëm në lidhje me dhënien dhe marrjen e informacionit për njësitë vartëse jashtë Bashkisë Tepelenë por edhe të tretë jashtë sistemit. Është funksionale faqja eeb-Bashkia Tepelenë, në të cilën ka informacione relativisht mjaftueshëm për aktivitetin, veprimtarinë, raporte monitorimi mbi realizimin e planeve vjetore, etje., por është evidentuar mangësia si më poshtë: Sa i përket komunikimit të brendshëm, nuk janë identifikuar, hartuar dhe miratuar llojet e raportimit brenda strukturave të bashkisë, më funksion të monitorimit të realizimit të objektivave strategjike dhe vjetorë të përcaktuara në planet përkatëse.

-Vlerësimin e punës së strukturës organike, bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

-Janë hartuar përshkrimet e punës për çdo pozicion pune dhe janë rishikuar për çdo vit. Janë kryer vlerësimet periodike të rezultateve individuale në punë të punonjësve sipas nënndarjeve dhe fushave përkatëse.

-Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, dhe ka plan vjetor të miratuar me vendimin nr.07/2 prot , datë 27.01.2023. Në 3 raste të testuara të rekrutimit rezultoi se ishin kryer procedurat në përputhje me ligjin për Shërbimin Civil. Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale, e cila përmbantë dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: çertifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; çertifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Gjithashtu nga Bashkia Tepelenë nuk është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxherët e programeve, e cila ti dërgohej Shkollës Shqiptare të Administratës Publike apo në institucione të tjera jashtë bashkisë (Organizata, Agjenci sipas fushave të ndryshme) për trajnimin e stafit me qëllim ngritjen profesionale sipas nevojave. (mungojnë të dhënat për trajnime jashtë institucionit)

-Për Bashkinë nëpunësi autorizues është Kryetari i Bashkisë, i cili është menaxher i vetëm si përgjegjës për zhvillimin dhe menaxhimin e çdo programi buxhetor. Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket

politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit. PBA dhe buxhetet vjetore janë miratuar me VKB përkatëse për cdo vit. NA për cdo vit ka nxjerrë Urdhrate ngritjes së GMS dhe të Ekipeve të Menaxhimit të Programeve.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015“Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”

neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se“Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

-Nëpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar.

Në lidhje me parimin 5 “ Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale” Në Rregulloren e Brendshme në pikën (27.1) të nenit 27 është parashikuar “funksionet/detyrat që delegohen” në zbatim të ligjit 44/2015 “kodi i Procedurave Administrative”si dhe nga verifikimi i dokumentacionit të dalë nga protokollin i institucionit rezulton se për periudhën objekt auditimi nuk ka patur Autorizime apo Urdhëresa për delegime detyrash.

-Në zbatim të ligjit organik të buxhetit, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr.23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte për përgatitjen e PBA të njësive të Qeverisjes Vendore” Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2023 për hartimin e PBA 2021-2023 është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik me 6 anëtarë (1 anëtar pa të drejtë vote) dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve për 19 programe buxhetore me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr.02, datë 10.01.2023. Është miratur Udhëzuesi i brendshëm nr.56/1 prot, datë 10.01.2023 “Për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së kontrollit të brendshëm në Bashkinë Tepelenë”

Në rregulloren e Brendshme nuk janë përcaktuar komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë, duke përfshirë dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS),për të cilin nuk përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitëe tij:

Nga verifikimi rezulton se GSM nuk e kryer detyrat si:

-Nuk ka dokument që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Nuk janë dokumentuar takimet dhe mbledhjet e anëtarëve të GMS për hartimin e planit strategjik dhe PBA.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Bashkia Tepelenë në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva ashtu dhe në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikimin e investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësive të përcaktuara në Planin e përgjithshëm Strategjik të Zhvillimit të Bashkisë Tepelenë. Këto objektiva bëhen të njohura, si në stafin e bashkisë nëpërmjet shkresave drejtuara Drejtorive dhe duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak, si dhe në dëgjesat me publikun.

Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla.

-Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave” Në Bashkinë Tepelenë ka përpjekje për krijimin e një praktike apo strategjie të menaxhimit të riskut dhe mekanizma të vlerësimit të riskut. Nuk ka Urdhër të Titullarit për përcaktimin e koordinatorit të riskut por është parashikuar në rregulloren e brendëshme neni 11, si dhe mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Është hartuar rregjistri i riskut, ku është bërë identifikimi dhe vlerësimi të risqeve për drejtorinë e Financës dhe Buxhetit si dhe Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, por jo për të gjitha Drejtoritë janë evidentuar rrisqet dhe janë përcaktuar veprime për të adresuar mangësitë. Duke mos u përcaktuar koordinatori i riskut dhe grupi i menaxhimit të riskut si pasojë dhe i mungesës së veprimtarisë së tij, nuk janë identifikuar e vlerësuar të gjitha risqet e mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të plota të veprimit për menaxhimin e riskut,

Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtrime”

Krahas vlerësimit të riskut ,ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskt për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

-Në Rregulloren e brendshme janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut por jo të grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithpërfshirëse.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”

Bashkia Tepelenë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara.

III. Komponenti: “ Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “ Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës, të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative,etj).

-Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

-Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i Financës/ Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë(NA).

Struktura e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar përbëhet nga 8 punonjës, 1 drejtor, 2 përgjegjës Sektori.

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit. Detyrat dhe përgjegjësit e NjHDT dhe KVO janë parashikuar edhe në nenin 32 të Rregullores së Brendshme

-Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh dhe objekte prokurimesh. Ekzistojnë dosjet e procedurave të prokurimeve, ku gjurma e auditimit e vërteton ekzistenca e evidencave të prokurimeve në këto dosje dhe evidencave financiare si urdhër-shpenzimeve të shoqëruar me dokumente autorizues, vërtetues dhe justifikues si kontrata, fatura, situacionet akt-marrjet në dorëzim, fletë-hyrjet etj., të vulosura nga dega e Thesarit, e cila konfirmohet me regjistrimin në SIFQ dhe kalimin e veprimit financiar, pasi ka bërë çeljen e fondeve sipas kërkesës së institucionit, duke konfirmuar fondet disponibël.

-Në Rregulloren e Brendshme neni 35.23 “Specialisti i Arshivës,” përcaktohen rregullat për ruajtjen e dokumentacionit, ndërsa për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por vepohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

-Për menaxhimin e aktiveve rregullat janë identifikuar në rregulloren e brendshmenë detyrat e drejtorisë Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar nenet 36 (36.1-36.16), por për menaxhimin e tyre vepohet në bazë të Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pikësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit material. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

-Bashkia Tepelenë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo cdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Në rregulloren e brendshme mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të IT. Faqja Zyrtare e bashkisë Tepelenë në internet ka një sistem back-up.

Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish.

Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave sipas funksionimit të sistemeve të IT, pasi secili nga këta specialistë mund të kontrollojë të gjitha fazat e funksionimit të TI si instalimin e softuerit, programimin, e testimin, menaxhimin e Serverit qendror, sigurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e sistemeve TIK etj. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk është përfshirë si drejtim auditimi nga AB.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”

-Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, ku përgjegjësitë janë të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e

përditshme të Bashkisë, nuk ka plan-veprime të ndryshme operative për menaxhimin e riskut, pavarësisht se është bërë identifikimi dhe vlerësimi i riskut sipas aktiviteteve.

-Në nenet nenet 36 (36.1-36.16) të rregullores së brendshme janë përcaktuar qartë dhe të ndara detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar për të gjitha nivelet në të gjitha aktivitetet e përfshira, duke eliminuar riskun që i njëjti person të mos kryejë dy detyra të njëpasnjëshme në 4 fazat e një transaksioni financiar si hartim, miratim, zbatim, monitorim.

-Për vlerësimin, përzgjedhjen, kostimin dhe monitorimin e investimeve, duke iu referuar dispozitave ligjore në fuqi merren Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe Drejtoria Planifikimit Zhvillimit Kontrollit të Territorit; Drejtoria e Shërbimeve Publike; Drejtoria e Zhvillimit Rural. Këto funksione janë përfshirë në detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre drejtorive neni 36 -38 dhe 41 të rregullores së Brendshme.

-Ekzistojnë procedura kontrolli të integritetit të dhënave financiare, pasi nga përgjegjësit e kontabilitetit kryhen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilzimeve e mbajtjen e ditarëve, hartimin e PF, rakordimet me thesarin e bankat e nivelit të dytë, hartimin e listpagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera, pastaj kontrollohen nga Drejtori. Pasqyrat Financiare konfirmohen nga NA dhe NZ.

Nga AB ushtrohet auditim mbi kontabilitetin dhe PF.Kontabiliteti dhe hartimi i pasqyrave financiare kryhet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi (pra Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.08.2018 “Për hartimin e PF”).Nga Auditi i jashtëm (KLSH) jepet opinion mbi besueshmërinë dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të Bashkisë në fund të vitit ushtrimor, mbi të cilat Bashkia është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr,gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Drejtesit në Bashkinë Tepelenë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacionale, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit.

-Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit.Ka Raportime periodike dhe vjetore për realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve kundrejt planit fondeve dhe analiza faktoriale të paraqitura pranë menaxhimit dhe këshillit bashkiak.

-Raportet për detyrimet e konstatuara, por të papaguara hartohen çdo 4 muaj dhe paraqiten në degën e thesarit dhe MFE.Stoku i detyrimeve të prapambetura për vitin 2023 është në vlerën 33874193 mijë lekë.Detyrimet dhe të drejtat janë paraqitur në llog. e klasës 4 në aktiv dhe pasiv të bilancit të PF.

-Drejtorja Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë për mbajtjen e kontabilitetit operon me program excel . Regjistrimet apo evidentimi në SIFQ i transaksioneve financiare së bashku me dokumentet shoqërues kryhet nga Specialistet e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar . Në bazë të këtij programi kontabiliteti me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe hartimi i pasqyrave financiare. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program Excel dhe program të veçantë që i menaxhon Sektori i Tatim-Taksave. Për çdo muaj dhe vit kryhen

akt-rakordimet me Degën e Thesarit Tepelenë për të ardhurat dhe shpenzimet. Të ardhurat arkëtohen nëpërmjet bankës. Mbahen akt-rakordimet me Agjentët Tatimorë si Shoqëria Rajonale UK ,DRT,ASHK, DRTRr etj. Për lëvizjet AAGJM mbahen dokumenta financiarë dhe për çdo vit kryhet inventarizimi i tyre. Për aktivet e amortizuara dhe pa vlerë përdorimi kryhen procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm, sistemin elektronik dhe shkresor.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm. Ka faqen e saj zyrtare.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, qarkullimit dhe mbajtjes së dokumentacionit brenda dhe jashtë institucionit në nenet : neni 13 “Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak” ; neni 19 “Informimi dhe komunikimi me median ”, neni 20 “Informimi dhe marrëdhëniet me publikun”, neni 9 “ Marrëdhëniet me institucionet e tjera”; neni 12 “Marrëdhëniet nëpërmjet strukturave të bashkisë” ”, neni 29 “Korrespondenca”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohen çdo 4 muaj dhe nëpërmjet analizave të herë pas herë sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Në përdorimin e emailit zyrtar kanë akses të gjithë punonjësit, por komunikimi zyrtar mes punonjësve të bashkisë realizohet me komunikim verbal e shkresor, gjithashtu kryhet edhe nëpërmjet sistemit elektronik përmes postës elektronike personale. Për mbledhjet e ndryshme të stafit drejtues dhe të menaxherëve me këshillin Bashkiak janë mbajtur procesverbale.Në faqen e Bashkisë Tepelenë janë të publikuar dokumentet kryesore, broshura,planet strategjike,raportet periodike, struktura organike,vendimet e këshillit bashkiak, publikime të ndryshme e shumë të dhëna të tjera nga veprimtaria e Bashkisë. Të gjithë drejtuesit e programeve kanë informacion mbi miratimet e buxheteve, alokimet dhe rialokimet, që ndodhin gjatë vitit buxhetor si dhe realizimet në fakt të shpenzimeve.

-Ka raporte periodike dhe publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut.

-Nga Bashkia Tepelenë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, të cilat janë të evidentuara në dokumentin e konsultimit publik.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

-Procedurat periodike të raportimit, që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

-Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet cdo 4 muaj.Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm,lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit e të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

-Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë Përgjithshme e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave,

-Për vitin 2023 me shkresën nr.prot.413/2, datë 28.02.2024, të cilat janë dërguar Njesisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave “Deklarata për cilësinë e e sistemit të kontrollit të brendshëm të njesisë Bashkia Tepelenë dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm”.

Në këto dokumente të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë në këto drejtime kryesore:

1. Vlerësimi i performancës së Aparatit të Bashkisë nëpërmjet monitorimit.
2. Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas përshkrimit në pyetësorin e vetëvlerësimit. Veprimtaria e sektorit të Auditit të Brendshëm në investigimin e drejtorive të Aparatit të Bashkisë dhe njësive vartëse.
3. Rekomandimet të metat dhe mangësitë e gjetura.
4. Hartimi i plan-veprimeve për zbatimin e rekomandimeve dhe sidomos për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që përshkruhen në aktivitete e Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe në përshkrimin e komponentëve të MFK.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësive, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

-në Bashkinë Tepelenë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e SMFdhekontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të MFK.

-Për sistemin e kontrollit të brendshëm janë dhënë rekomandime nga KLSH, ndërsa nga Auditimi i brendshëm nuk ka rekomandime.

-Në Bashkinë Tepelenë aktivitetet e vlerësimit të njesisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Raportet e Zbatimit për Planet e Menaxhimit, nëpërmjet vlerësimeve të performancës lidhur me progresin e arritjeve të objektivave përshtatshëmërisë dhe efektiviteti i shërbimeve publike e shoqëruar me analizë për shkaqet e mosrealizimeve dhe dhënien e alternativave për zgjidhjet e mundshme.

-Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i brendshëm në periudhën objekt auditimi ka dhënë vlerësime për sistemin e kontrollit të brendshëm vetëm në auditimet në institucionet e varësisë dhe jo për Drejtoritë e Aparatit të Bashkisë, duke u shprehur në të njëjtin format dhe pa u thelluar analitikisht për të gjitha subjektet e audituara

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezente në mbledhjet periodike me Kryetarin e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

- Titullari i këtij institucioni si për rekomandimet e lëna nga KLSH edhe për ato të lëna nga Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Konkluzion: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nga verifikimi rezulton se GSM nuk ka kryer detyrat si: Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, dhe merr vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet, por mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës të specialistit të IT.

“Menaxhimi i Riskut”

Është përcaktuar koordinatori i riskut me rregullore, por nuk është ngritur grupi i punës së riskut, mungesa e të cilëve e për pasojë dhe mungesës së veprimtarisë së tij, ka sjellë mos identifikimin e vlerësimit të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm me qëllim hartimin e planeve të veprimit për menaxhimin e riskut. Në raportet e Auditit të Brendshëm nuk trajtohet funksionimi i procesit të menaxhimit të riskut. Krahas vlerësimit të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut, dhe si rezultat gjatë monitorimit të zbatimit të Buxhetit, Bashkia nuk mund të përcaktojë nivelin e dëshiruar të performancës financiare, dhe nëse janë arritur objektivat në nivelin e dëshiruar.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Tepelenë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Nuk ka manuale të përdorimit të sistemit të IT. Nuk ka ndarje të detyrave të funksionimit të sistemeve të IT, pasi ka nmungesa në burime njerëzore. Pra mungon gjurma e auditit për funksionimin e sistemeve të TI të miratuar nga Kryetari si dhe nuk fushë drejtimi auditimi nga AB.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Në zbatim të pikës respektive programit të auditimit, u shqyrtua dokumentacioni fizik pranë Bashkisë Tepelenë, Sektori i Auditit të Brendshëm, si më poshtë:

- ❖ Plani Strategjik dhe Vjetor për periudhën 2022-2024.
- ❖ Raporti vjetor 2023 dhe pasqyrat e miratuara.
- ❖ Dosjet e auditimit për vitin 2023.

➤ Organika e miratuar për Bashkinë Tepelenë, paraqitet si vijon:

Nr.	Emertimi	Nr. Punonjësish (Plan)	Nr. Punonjësish (fakt) 2023
1	Përgjegjës Sektori	1	1
2	Specialist	0	0
Total		1	1

Struktura e Njesisë së Auditimit të Brendshëm është miratuar me urdhër të kryetarit të Bashkisë me datë 05.02.2020 me përbërje sipas strukturës 1 përgjegjës. Për vitin 2022 Njësia e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 përgjegjës. Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë e Tepelenë është e organizuar si Njësi në varësi të drejtpërdrejtë të Kryetarit të Bashkisë .

-Struktura e personelit të Njesisë është:

- ❖ Ekonomist 1 Përgjegjës Sektori. Punonjësit e sektorit të AB janë të certifikuar si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik”, në bazë të Ligjin Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik“, çertifikimi për punonjës in ka pëfunduar në Shtator 2021.
- ❖ Për periudhën Janar-Dhjetor 2023, Sektori i Auditit të Brendshëm ka funksionuar me 1 punonjës.
- ❖ Me shkresën nr.215/1 prot datë 15.06.2021, është rishikuar dhe hartuar nga Sektori i Auditimit të Brendshëm dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë “Karta e Auditimit të Brendshëm”, kjo bazuar në ligjin Nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në sektorin

publik” në nenin 4 pika “12”, në nenin 12 pika “c”), me përcaktimin e statusit organizativ, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmëritë dhe përgjegjësitë e auditit të brendshëm.

- ❖ Gjatë periudhës së auditimit, në Bashkinë Tepelenë struktura e sektorit të Auditit, nuk ka qenë e plotësuar.

-Njësia e AB në Bashkinë Tepelenë mbulon me auditim:

1. Njësia Administrative Qytet Tepelenë.
2. Njësia Administrative Qendër Tepelenë.
3. Njësia Administrative Kurvelesh.
4. Njësia Administrative Lopes, si edhe sektorët e mëposhtëm :

Drejtoria e Financës, Sektori I Tatim Taksave(2 fusha), Drejtori e financës (Auditime të prapambetura)

➤ ***Komiteti i Auditit të Brendshëm:***

Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të, në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se :“*Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:*

- a) duke siguruar pavarësinë e audituesit të brendshëm;
 - b) duke vlerësuar dhe dhënë mendime për planin strategjik dhe vjetor;
 - c) duke vlerësuar përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
 - ç) duke siguruar një monitorim të zbatimit të planit dhe rezultateve të auditimit;
 - d) duke monitoruar zbatimin e rekomandimeve të dhëna;
 - dh) duke këshilluar për çështjet lidhur me risqet, sistemet e kontrollit të brendshëm e të auditimit.
2. Komiteti i Auditimit të Brendshëm, në ato njësi publike ku krijohet, e shtrin autoritetin për të gjitha njësitë e varësisë.
 3. Mënyra e funksionimit, kompetencat dhe përbërja e Komitetit të Auditimit të Brendshëm rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave.

➤ **Viti 2023**

Me shkresën nr.2528, datë 19.10.2022, është dërguar Plani Strategjik dhe Vjetor i veprimtarisë së NjAB, për Bashkinë Tepelenë për vitet 2022 – 2024, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit për Auditin e Brendshëm. Me shkresën nr.398, datë 15.02.2023, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Tepelenë për vitin 2022, Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, Drejtorisë së Harmonizimit për Auditin e Brendshëm.

-*Plani Strategjik për periudhën 2022 – 2024, përbëhet nga :*

Pasqyra Nr .1- Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet për vitin 2022-2024

Pasqyra Nr.2 - Plani Strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar 2022-2024.

Pasqyra Nr.3- Plani i Angazhimeve të NJAB për vitin 2023

Pasqyra Nr.4 – Planifikimi vjetor i nevojave për trajnim të NJAB për vitin 2023

Pasqyra Nr.5 – Planifikimi vjetor i buxhetit dhe shpërndarja e burimeve të NJAB për vitin 2023

Në planin vjetor të angazhimeve të auditimeve janë përcaktuar objektivat për tu audituar. Sipas kësaj pasqyre janë përcaktuar për tu audituar në vitin 2023, gjithsej 8 njësi..

- ❖ Auditim Financiar 4.

❖ Auditim të Kombinuara 4.

➤ **Planifikimi dhe realizimi 2023**

	Planifikimi 2023	Realizimi 2023
a.		
1	Drejtoria e Financës dhe 4 NJ.ADM (në dy fusha në Bashkinë Tepelene.	Drejtoria e Financës dhe 4 NJ.ADM (në dy fusha në Bashkinë Tepelene.
2	Spektori i Tatim Taksvae (2 fusha) 4 NJ.ADM.	Spektori i Tatim Taksvae (2 fusha) 4 NJ.ADM.
3	Drejtoria e Financës (Detyrime të prapambetura.)	Drejtoria e Financës (Detyrime të prapambetura.)

Për periudhën raportuese janë realizuar gjithsej 8 angazhime nga 8 angazhime të planifikuara, ose 100% e planit. Referuar Raporteve të Auditimit për cdo angazhim janë identifikuar **gjithsej 24 parregullsi**.

➤ **Dosjet e audituara për vitin 2023**

1. Programi i Angazhimit me nr.2219, datë 01.11.2023, për Auditimin e Detyrimeve të prapambetura për 10-mujorin e fundit të vitit 2023.

2. Programi nr.635/2, datë 10/03/2023, për auditimin e Drejtoria e Financës dhe 4 NJ.ADM (në dy fusha në Bashkinë Tepelene).

3. Programi 1439, datë 09/06/2023 mbi auditimin e Spektori i Tatim Taksvae (2 fusha) 4 NJ.ADM. Për vitin 2023, në Bashkinë Tepelene, është kryer Zbatimi i Rekomandimeve (detyrat e lëna), të vitit paraardhës, **por nuk është kryer verifikimi i Zbatimit të rekomandimeve të 6-mujorit paraardhës**.

➤ **Nisur nga sa më sipër, grupi audituesve, ka konstatuar si më poshtë vijon:**

-Struktra e NJAB e paplotësuar.

-Nga auditimi i grupit të KLSH për vitin 2023 janë audituar 4 dosje të realizuara në subjektet e lartpërmenduara, ku rezulton se nga NjAB dosjet nga ana dokumentimit administrativ janë përgjithësisht korrekte, por ka patur mangësi në plotësimin e kërkesave që janë të parashikuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm.

-Në përgjithësi nga NJAB është respektuar procedura e auditimit në përputhje me bazën ligjore dhe manuali i auditimit të brendshëm .

-Nga auditimi u konstatua se janë respektuar afatet e auditimit, ku me saktësisht, raporti përfundimtar i auditimit referuar manualit për manxhimin financiar duhet ti dërgohet subjektit 7 ditë pune pas reagimit të subjektit, afat i cili është respektuar.

-Nga auditimi u konstatua se në dosje ka plane veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të angazhimit të auditimit për 6 – mujorin paraardhës e cila plotësohet nga njësia publike e audituar si dhe e miratuar nga titullari jo me vonë se 20 ditë pune pasi subjekti njihet me raportin përfundimtar, i dërguar njësisë, në përputhje kjo me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për vitin 2023, në Bashkinë Tepelene, është kryer Zbatimi i Rekomandimeve (detyrat e lëna), të vitit paraardhës, por nuk është kryer për 6-mujorin paraardhës nga Spektori i Auditimit të Brendshëm .

-Gjithashtu nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në këtë bashki.

2. AUDITIM MBI PLANIFIKIMIN, ZBATIMIN DHE MONITORIMIN E PLANIT TË BUXHETIT

Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, e PBA dhe programimit të buxheteve vjetore

Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2023-2025

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025 rezultoi se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr.2 datë 10.01.2023 mbi bazën e të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë prej 6 punonjësish dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP). Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 dhe buxheti i vitit 2023, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

-Programi Buxhetor Afatmesëm 2023-2025 është miratuar me VKB nr.94, datë 25.11.2022 nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimit të MFE nr. 8, datë 28.02.2022 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025".

-Në këtë programim është përgatitur dhe përfshirë instrumenti i planifikimit financiar, shoqëruar me relacionin shpjegues, i cili është dërguar në MFE me shkresën nr.1243 prot., datë 01.06.2022 dhe përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogariza ekonomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

-Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimitet e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2023-2024-2025.

-Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga FZSHH. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

-Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollat përkatëse.

-Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2023-2025 dhe buxheteve vjetore, rezultoi se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative dhe nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Tepelenë në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, si dhe kërkesa nga sektorë të ndryshëm, që mbulojnë këto programe

-Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat.

-Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresën nr.prot.1243, date 01.06.2022

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje".

Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2023

Për vitin 2023 buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 95, datë 25.11.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.1169/1 date 09.12.2022, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Plani i vitit 2023	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	60.000	
2	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar	99.758	
3	Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	100.933	
4	Te ardhura te trashëguara nga viti 2022	2.000	
8	Paga (600)		129.192
9	Sigurime shoqërore (601)		21.576
10	Shpenzime operative (602)		67.673
11	Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë		22.150
12	Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike		22.100
13	Investime ne proces		0
Totali i buxhetit		262,691	262,691

Sipas tabelës së mësipërme buxheti i vitit 2023, është miratuar i balancuar dhe pa defiçite,ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 262,691 mijë lekë.

Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

	Emërtimi	Plan fillestar 2023	PBA 2023-2025	Ndryshim
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec)	150.768	150.768	
2	Shpenzime (602.shp Op.+604 nd.ek.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif)	89.823	89.823	
3	Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez)	22.100	22.100	
4	Investime nga FZSHS	0	0	
	Total I planit fillestar	262.691	262.691	
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant i kushtëzuar			
6	Shpenzime për pagat (600+601)			
7	Shpenzime (602.604.609)			
8	Grant i kushtëzuar (230-231)			
	Gjithsej	262.691	262.691	

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2023 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2023-2025, rezulton se nuk ka diferencë.

Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Tepelenë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha

të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit. Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Tepelenë dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Tepelenë. Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2023 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Pakësuar/shtuar artikulli (me emër)			
	Nr./datë	Vlera	Nr./datë	Vlera	Shtesa art.	shuma	Paksime art.	Shuma
Viti 2023	Nr.95,dt.25.11.2022	262.691.000	VKB 79,dt.21.9.2023	14.900.000	600 pagat	10.450.000	609,transferta	6.500.000
					602 shpenzime operative	3.800.000	601 sig.shoqerore	2.650.000
					606,transferat	650,000	231,investime	5.750.000
					14.900.000		14.900.000	

Konkluzion:Nga sa më sipër konstatohet se janë kryer ndryshime, ku për vitin 2023 ka ndodhur 1 ndryshim në vlerën 14.900.000 lekë, tregojnë qartë për planifikime optimiste, të cilat gjatë vitit ushtrimor nxisin shkurtrimin e shpenzimeve, ose rishpërndarje të shpeshta mes kapitujve dhe artikujve.

Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Tepelenë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Tepelenë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2023, të miratuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara. ng auditimi i shkresave, evidencave të çeljeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Tepelenë u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	2023		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	158.485	154.690	97.5%
2	Sigurime shoqërore 601	16.003	14.965	93.5%

Nr.	Emërtimi	2023		
		Plan	Fakt	Real.%
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	98.796	95.522	96.7%
4	Transferime 604(Kësh.Qarkut,Reload,Sporti)	7.675	6.146	80%
5	Nd/Ekonom invalid 606	121.087	119.188	98.4%
6	Investime (230/231)	84.375	74.393	88.2%
7	Mjete ne ruajtje 466			
	Totali	486.421	464.905	95.6%

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizimit të treguesve të buxhetit:

- Për vitin 2023 janë realizuar 464.905 mijë lekë nga 486.421 mijë lekë të planifikuara, ose në masën 95,6 %.

Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Tepelenë. Në këtë masë realizim ka ndikuar realizimi në masë të ulët në zërat e buxhetit:

Shpenzimet operative llog.602 janë realizuar në masën 96.7%

Transferime 604 (Këshilli i Qarkut,Sporti) janë realizuar në masën 80 %,

Shpenzimet për investime llog.231 janë realizuar në masën 88.2%.

Konkluzion: Mosrealizimet në programet kryesore të veprimtarisë së bashkisë tregon se, planifikimi i tyre duhet të bëhet më i argumentuar dhe duke mbajtur parasysh përcaktimin e drejtë të kostos së produkteve në mënyrë që, programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më reale. Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë transferimet tek individët për ndihmë ekonomike e invaliditeti, ndjekur nga shpenzimet për investime dhe shpenzimet për paga personeli.

Nr.	EMËRTIMI	Përqindja ndaj totalit
		Viti 2023
1.	Transferime	25.6%
2.	Investime	16%
3.	Shpenzime për paga	33.3%

Miratimi i realizimit faktik të buxhetit

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Tepelenë është miratuar buxheti vjetor, ku për vitin 2023 është miratuar me vendim të KB nr.11, datë 27.02.2024.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës

Fondi rezervë për vitin 2023 është në total në shumën 12.500 mijë lekë, i cili është miratuar që nga buxheti fillestar e deri në fund të vitit buxhetor me VKB dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastr.

- Miratimi fillestar me VKB nr. nr. 95, datë 25.11.2022 në vlerën 12.500 mijë lekë

Përdorimi i Fondit Rezervë në vlerën 12.500 mijë lekë, konkretisht:

-V.K.B nr.79 dt.21.09.2023 perdorur per paga dhe sigurime 8.000 mije leke, transferta për individë, 650 mije lekë dhe shpenzime operative 3.850 mijë lekë.

Raportet e Monitorimit.

Për vitin 2023, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit

buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 6. Për vitin 2023 është dërguar “Raport monitorimi Buxhetit Janar–Prill” me shkresën nr.prot. 981, datë 09.05.2023,“Raport monitorimi Buxhetit Janar–Gusht” me shkresën nr.838 prot datë 11.09.2023,“Raport monitorimi Buxhetit Janar–Dhjetor” me shkresën nr.283 prot datë 09.02.2024. Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore", pika 10, 12, 28, 29, 48.

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizmit të të ardhurave

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikojë procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës, kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likuidimi i faturave të palikujduara

Me fondet e vitit buxhetor 2022, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Bashkia, nga Ministritë e linjës apo FZSHH sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Periudha	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr. /datë	Llog 602	Vendime gjyqësore	Llog. 230-231
Viti 2023	14.500.000	14.500.000.	88, date 30.11.2023	10877.000	123.000	3.500.000

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2022 (lekë)	Detyrimi i krijuar në periudhën 01/01/2023 - 31.12.2023 (lekë)	Total detyrime (lekë)	Shlyerja e detyrimeve 2023 (lekë)	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2023 (lekë)
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministritë e linjës e FZSHH					
b. Investime nga Bashkia	4,983,229	545.100	5.528.329	0	5.528.329

INVESTIME :					
Mallra dhe shërbime	21.067.156	16.334.896	37.402.052	9.179.187	28.222.865
Vendime gjyqësore	122.999		122.999		122.999
Totali :	26.173.384	16.879.996	43.053.380	9.179.187	33.874.193

Referuar shkresës nr.prot.130, datë 18.01.2024 “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura” të Bashkisë Tepelenë dërguar në MFE e për rrjedhojë dhe publikimit të detyrimeve të prapambetura në faqen e MFE në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 26,173,384 lekë dhe në fund të vitit 2023 referuar shkresës nr.prot.130 datë 18.01.2024 “Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura” në shumën 33,874,193 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar 16,879,996 lekë, por njëkohësisht është likuiduar vlera prej 9,179,187 lekë, por detyrimet e prapambetura na paraqiten në rritje në vlerën 7,700,809 lekë.

Shënim : Detyrimet e raportuara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2023 me shkresën nr.130 prot datë 18.01.2024 janë në vlerën 16,879,996 lekë, që i përkasin detyrimeve të krijuara vetëm brenda vitit 2023 dhe paraqiten në aneksin bashkëlidhur.

Konkluzion:Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2023 Bashkia Tepelenë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 33,874,193 lekë, e cila ka ardhur duke u rritur.Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2023 rezultoi se është bërë planifikimi i fondeve të vecuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në përputhje me kërkesat Udhëzimit të MFE nr.09, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit”.

Detyrimet e prapambetura për vitin 2023 të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.130 prot datë 18.01.2024 jepen në tabelën si më poshtë :

NR	Emërtimi	Stoku	Totali shpenzime faktike për NJVQV	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJVQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua sfatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	33,874,193		12.5%
Llog.ekonomike	Emertimi	,33,874,193		
4864100	Vendime gjyqësore	122.999		
4864200	Det.prapambetura shërbime	3,518,978		
4864201	Det.prapambeture energji elektrike	6,820,872		
4864300	Det.prapambetura mirembajtje	3,317,713		
4864400	Det.prapambetura investime	5,528,329		
4864600	Det.prapambetura mallra	14,565,302		
III	Totali (I+II)	33,874,193	273,053,170	

Situatë normale e gjendjes Financiare.

Nga auditimi është konstatuar se detyrimet e papaguara (të akumuluar) në fund të vitit 2023 paraqiten në vlerën 33,874,193 lekë dhe fondet faktike për shpenzime të këtij viti janë në vlerën 273,053,170 lekë (464,904,831, lekë totali i planifikuar –191,851,661 lekë transferta e kushtëzuar ndihmë ekonomike & invaliditet).Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 12,41 % kundrejt fondeve të miratuara.Kjo situatë tregon se, Bashkia Tepelenë është në situatë normale të gjendjes financiare në fund të vitit ushtrimor 2023,pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 15%, sipas nenit 56 “Vështirësia financiare” të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për investime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta (minimale) të BashkisëTepelenë.

- Për vitin 2023 janë planifikuar fonde për investime në shumën 84,375,000 lekë(nga te cilat 14,106,160 lekë janë nga granti i pakushtëzuar + transferta sektoriale + të ardhura dhe 70,268,840 lekë transfertë e kushtëzuar M.linje), realizuar dhe likuaduar në vitin 2023 në vlerën 74,393,476 lekë. Realizimi në masën 88,1% i investimeve ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve si mos realizimi i të ardhurave.

Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime, të cilat janë shqyrtuar nga GMS, i cili ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me VKB për secilin rast.

Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

000 lekë

Nr	Objekti i kontratës	Fond Planifikim	Kontrata me subjektin			Subjekti kontraktuar	Paguar Viti 2023	Mbetja 31.12.2023	Komente
			Datë lidhjes se kontratës	Afat i	Vlerë kontrate me TVSH				
1	Rikonstruksion fasada unaza veriore	14,300	20/6/2019	30 dite	8,261	N. S.	2,000	3,261	Lik.ne vazhdi
2	Rikonstruksion rruge ne qytet dhe blloqe banimi	12,125	6/9/2021	30dite	7,856	N. SHPK	0	6.356	Lik.ne vazhd
3	Rikonstruksion rruga “Bilbilenjte”	6,500			4,983	SH.	0	4,983	Lik.ne vazhd
4	Blerje makin teknologjike pastrimie	5,500	16/6/2022	30 dite	4,750	S. CO	0	497	Lik.ne vazhd
5	Rikonstruksion rruga fshati Mamaj	14,286			9,360	T.-D	0	9,360	Lik.ne vazhd
6	Blerje paisje kompjuterike	1,200	Blerje vogel		1,139	E.H.	1,130	0	Perfunduar
7	FV kaldaje Kopeshti femijeve “M.Kociu”	1,080	Blerje vogel		870	S. SHPK	870	0	Perfunduar
	Totali grant i pakushteuar + tarsnsferta sektoriale + të ardhura	71,925			36,979		4,000	24,457	
	Buxheti I shtetit								
8	Rikosntruksion Ujesjellesi Progonat-Dhemblan	133,343	22/12/2020	180 dite	126,451	E. C.	1,182	0	Perfunduar
9	Supervizim ujesjellesi Progonat-Dhemblan	2,428	11/1/2021		2,428	I.	322	0	Perfunduar
10	Ndertim ujesjellesi fshati Salari	34,898	14/4/2021	150 dite	34,796	2. SHPK	0	14,296	Lik.ne vazhdim
11	Supervizim ujesjellesi Salari	910	18/3/2021		838	G. C.	0	482	Lik.ne vazhdim
12	Ndertim ujejellesi Nivice-Peshtan	235,000	26/4/2021	150 dite	232,667	2. SHPK	0	145,667	Lik ne vazhdim

13	Supervizim ujesjellesi Nivice-Peshtan	3,472	10/9/2021		3,469	I.	0	2,435	Lik.be vazhdim
14	FV vendosje matesa uji ne kollone	14,695			14,693	N.STRUCTUR ES	14,693	0	Perfunduar
15	Mbikqyrje punimesh FV matesa uji ne kollone	380	16/12/2022		354	E. C.G.	100	254	Lik ne vazhdim
16	Rikonsrtruksioni shkolla 9 vjecare A.Rustemi	130			129,596	N.S.	55,476	65,120	Lik ne vazhdim
	Totali transfert e kushtezuar M.linje	410,051			400,649		71,773	228,254	
Totali i vitit 2023		481,976			437,628		75,773	252,711	

Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e investimeve në nivel projekti paraqiten si më poshtë:
Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 16 projekteve të investimeve Bashkia Tepelenë, rezultoi se janë realizuar dhe finalizuar me kontratë 3 projekte.

-Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 16 projekteve të investimeve Bashkia Tepelenë, rezultoi se janë ndjekur hapat:

Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Tepelenë . Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Tepelenë dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent.Kontrata është regjistruar e plotëme qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor.Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit.

Burimet e financimit të buxhetit vjetor

Realizimi i buxhetit për vitin 2023 sipas burimit të financimit

000/lekë

Nr	Emertimi	2022		
		Plan	Fakt	Real.%
1	Paga 600	158,484,776	154,689,759	97.6
	grant I kushtezuar	3,368,940	3,365,373	99.9
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta sektoriale	125,420,836	125,314,136	100
	te ardhura	29,695,000	26,010,250	87.5
2	Sigurime shoqërore 601	16,002,945	14,965,236	93.5
	grant I kushtezuar	326,945	326,857	100
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	11,115,000	11,005,200	99
	te ardhura	4,561,000	3,633,179	79.6
3	Shpenz.operative 602+ F.rezerve	98,796,195	95,521,615	96.6
	grant I kushtezuar	4,582,620	4,579,862	100
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	74,969,575	74,931,336	100
	te ardhura	19,244,000	16,010,417	83.2
4	K.Qarkut Transferime 604	7,675,172	6,146,527	80
	grant	2,595,172	2,595,123	100
	grant I kushtezuar	3,580,000	3,250,000	90.7
	te ardhura	1,500,000	301,404	20
5	Nd ekonomike invalid 606 ,bonus strehimi ,ndihma financiare	121,087,272	119,188,218	98.4
	grant I kushtezuar	114,967,272	113,511,198	98.7
	grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike	3,620,000	3,604,500	99.5
	te ardhura	2,500,000	2,072,520	83
6	Investime 230-231	84,375,000	74,393,476	88
	grant I kushtezuar	70,268,840	70,268,756	100

	grant I pakushtezuar + trasnsferta specifike	6,060,160	4,124,720	68
	te ardhura	8,046,000	0	0
	Totali Bashkia Tepelenë	486,421,360	464,904,831	95.6

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:

- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” për vitin 2023 në masën 1.68%
- Shpenzimet në artikullin 601 “kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” për vitin 2023 në masën 2.2%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “shpenzime operative për mallra e shërbime” për vitin 2023 në masën 1.68 %.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “investime” për vitin 2023 në masën 0 %.
- Shpenzimet në artikullin 604 “transferime “ për vitin 2023 në masën 0.49%.

Duke u nisur nga burimi i financimit për vitin 2023 shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 48,048 mijë lekë ose në masën 10,3 %, nga transferta e pakushtezuar dhe transferta specifike në shumën 222,229 mijë lekë ose në masën 47.8 %, nga transferta e kushtëzuar në shumën 194,628 mijë lekë ose në masën 41.9 % .

Në zbatim të Programit të Auditimit cituar më sipër pika 2, nënpika 2.6, u auditua **burimi i krijimit të të ardhurave dhe vlerësimi i mbledhjes së tyre bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore është si vijon:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak Tepelenë për miratimin e paketave fiskale të vitit 2022;
- Pasqyrat financiare në lidhje me arkëtimet, kontabilizimin dhe pasqyrimin e të ardhurave nga subjektet dhe familjarët, lidhur me taksat dhe tarifave vendore;
- Dokumentacioni i Sektori i Tatim Taksave, në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave dhe dokumentacionit të tatim-paguesve;
- Kontrata, procesverbale dhe relacione në lidhje me të ardhurat;
- Regjistrat dhe mbajtja e debitorëve për bizneset, për taksat dhe tarifave vendore;
- Realizimi faktik i të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave.

Dokumentacioni që u analizua për të vlerësuar pagesat e kontratave të qirave të aseteve është:

- Kontratat e aseteve të dhëna me qira;
- Dosjet përkatëse të subjekteve që kanë marrë asete me qira;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion lidhur me monitorimet e kontratave dhe likuidimet e pagesave të qirave.

Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë është miratuar me VKB-në nr. 92, datë 25.11.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresë nr. 2827/3 prot., datë 30.11.2022.

Nr.	EMËRTIMI	PLAN	FAKT	%
-----	----------	------	------	---

I	Të ardhura nga Taksat	35,990,000	15,746,996	44%
1	Pasuri të paluajtshme	5,689,000	3,636,683	64%
2	Taksë trualli	498,000	1,141,441	229%
3	Zënie hapësire publike	429,000	570,310	133%
4	Fjetje hoteli	-	1,960	
5	Parkim + tregu	250,000	580,000	232%
6	Tabelë	233,000	550,520	236%
7	Regjistrimi vjetor i automjeteve	4,200,000	5,820,640	139%
8	Tokës bujqësore	900,000	577,270	64%
9	Kalimit të drejtës së pronësisë	24,000	7,000	29%
10	Ndikimi në infrastrukturë	22,000,000	2,077,889	9%
11	Shfrytëzimi lëndë drusore	1,172,000	295,050	25%
12	Kullotë	595,000	488,233	82%
II	Të ardhura nga Tarifa	22,414,000	28,030,672	125%
1	Pastrimi	3,936,000	4,854,334	123%
2	Reklame	-	-	
3	Therje	36,000	12,500	35%
4	Ndriçim	2,554,000	2,348,258	92%
5	Leje transporti	90,000	73,782	82%
6	TAP	1,500,000	3,773,153	252%
7	Çerdhe	840,000	818,332	97%
8	Rent minerare	120,000	92,712	77%
9	Qira nga ndërtesat	70,000	69,800	100%
10	Gjelbërimi	1,785,000	1,961,185	110%
11	Leje tregtare nga karburantet	600,000	1,800,000	300%
12	Kamata	200,000	111,014	56%
13	Qira toke bujqësore	1,075,000	1,121,879	104%
14	Të tjera	1,206,000	4,992,059	414%
15	Qira kullote	5,630,000	5,716,664	102%
16	Të tjera debitore	2,000,000	-	
17	Shërbimi MNZ-së	12,000	25,000	208%
18	Të tjera qira (telefoni celulare)	760,000	260,000	34%
III	Të Tjera	996,000	1,145,366	115%
1	Shërbim Legalizim+privat. Banesa	-	-	
2	Shërbim varrimi	996,000	1,145,366	115%
IV	Të ardhura nga sponsorizimet	-	1,539,000	
V	Tatim i thjeshtuar nga fitimi	600,000	140,435	23%
	TOTALI I TË ARDHURAVE	60,000,000	46,602,469	78%

Referuar të dhënave të paraqitura në tabelën më sipër për periudhën nën auditim realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Tepelenë për vitin 2023 është në masën **75%**

nga 60,000 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 45,063 mijë lekë (pa përfshirë sponsorizimet).

Sipas përcaktimeve e kuadrit ligjor dhe rregullator për hartimin dhe zbatimin e buxhetit, përkatësisht:

- Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar;
- Ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Për vitin 2023 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë është miratuar me VKB-në nr. 92, datë 25.11.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresë nr. 2827/3 prot., datë 30.11.2022.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet llogaritet në bazë të përcaktimeve të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c¹ dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlera vetë zbatueshme për legalizim”, pika 5².

Në Bashkinë Tepelenë struktura që administron dokumentacionin dhe përlllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë referuar kërkesave ligjore të sipër cituara për subjektet dhe qytetarët që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Në procesin e legalizimeve për vitin 2023 rezulton se, janë legalizuar 13 objekte me vlerë totale 278,190 lekë dhe janë debitorë 3 subjekte me vlerë 37,912 lekë, si në tabelën mëposhtë.

Në lekë

NR	EMËR MBIEMER	ADRESA	SIPËRFAQJA	DETYRIMI	LIKUJDUAR	DEBITOR
1	M. R.	TEPELENË	153.7 M2	25,063	25,063	-
2	L. H.	TEPELENË	27.7 M2	4,517	4,517	-
3	K. D. C.	TEPELENË	59.5 M2	9,702	9,702	-
4	A. T. B.	MAMAJ	92 M2	15,002	15,002	-
5	L. R. R.	MAMAJ	25 M2	4,076		4,076
6	A.M. GJ.	TURAN	255 M2	41,582	41,582	-
7	A. I. C.	DRAGOT	99.6 M2	16,241	16,241	-
8	SH. M. B.	LUZAT	97.2 M2	15,850	15,850	-
9	A. P. H.	TEPELENË	75.5 M2	12,311		12,311

¹Ligji nr. 95.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesane ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c “për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi”.

²VKM nr. 860, datë 10.12.2014, pika 5: “Taksavendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njërive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi”.

10	K.S. A.	TEPELENË	620 M2	101,103	101,103	-
11	M.S. Z.	MAMAJ	132 M2	21,525		21,525
12	F. P. H.	PROGONAT	47.2 M2	7,696	7,696	-
13	B. B. Z.	TEPELENË	21.6 M2	3,522	3,522	-
	TOTALI			278,190	240,278	37,912

Nga auditimi konstatohet se lidhur me ecurinë e pagesave që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezultoi se për vitin 2023 nga 13 objekte të legalizuara me vlerë 278,190 lekë kanë paguar detyrimin 10 subjekte me vlerë 240,278 lekë dhe nuk kanë paguar 3 qytetarë me vlerë 37,912 lekë. Ndërsa nga vitet e mëparshme janë 58 debitorë në vlerë totale **2,059,646 lekë, që përbën 61 debitorë në vlerë totale 2,097,558 lekë, që përbën detyrim për arkëtim në buxhetin e Bashkisë Tepelenë,** (për më shumë informacion shiko aneksin II.6.1).

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore

Administrimi i taksave dhe tarifave vendore për subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjarë ku përfshihen regjistrat, pagesat e kryera, detyrimet e pa likuiduara etj, në Bashkinë Tepelenë kryhet në programin Excel. Sektori i Tatim Taksave gjithashtu kryen edhe regjistrim manual të të dhënave (regjistra fizik) dhe të çdo informacioni lidhur me subjektet apo familjet objekt i taksave dhe tarifave vendore.

Nr.	Lloji Biznesit	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të Vitit
1	Biznesi Vogël	355	24	10	369
2	Biznesi Madh	111	5	0	116
	Gjithsej	466	29	10	485

Menaxhimi i borxhit

Në realizimin në nivel të ulët të të ardhurave kanë ndikuar **niveli i lartë e debitorëve.** Në bazë të përpunimit të të dhënave të regjistratit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Sektori Tatim Taksave në Bashkinë Tepelenë rezultoi se, ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, (për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie, tarifa e qirasë për objekte, toka, pyje, dru zjarri, etj.), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2022** vlera debitorëve është **20,381,318 lekë** dhe në fund të **vitit 2023** vlera debitorëve është **22,233,772 lekë** (me e detajuar në Aneksin nr. II.6.2). Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë paraqitet në tabelën mëposhtë.

NR	Subjekti	VLERA E DEBITËSË 31.12.2022	SHTESA GJATË PERIUdhËS 2023	PAGESAT GJATË PERIUdhËS 2023	DETYRIMI 31.12.2023
1	Biznes i madh	10,922,734	1,696,578	1,082,741	11,536,571
2	Institucione	622,468	147,180	-	769,648
3	Biznes i vogël	508,989	181,088	91,017	599,060
4	NJ.A. Qendër	8,327,127	2,371,004	1,369,638	9,328,493
	TOTAL	20,381,318	4,395,850	2,543,396	22,233,772

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën **20,381,318 lekë**, vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **4,395,850 lekë** ndërkohë që janë bërë pagesa në vlerën 2,543,396 lekë dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2023** është në vlerën **22,233,772 lekë, që përbën detyrim për arkëtim.**

Taksat dhe tarifat familjare

Në Bashkinë Tepelenë aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës. Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve, që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Tepelenë nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifën e tjera të miratuara me VKB, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Bashkia Tepelenë ka si Agjent Tatimor për arkëtimin tarifës së pastrimit dhe taksën e ndërtesës Sha Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, e cila sipas akt-rakordimit me Bashkinë Tepelenë për të ardhurat rezulton se **deri në fund të vitit 2022** ka mbetur pa u derdhur Bashkisë **vlera në mënyrë progresive prej 16,397,158 lekë, që përbën detyrim për arkëtim në buxhetin e Bashkisë Tepelenë.**

Gjithashtu **për vitin 2023 dhe muajt Tetor - Dhjetor 2022 debia e taksave familjare është 2,785,790 lekë që përbën të ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Tepelenë**, të cilat nuk janë pasqyruar në bilancin e vitit 2023, pasi rakordimi është bërë në vitin 2024 dhe bilanci ishte mbyllur.

Të dhënat për maturimet, derdhjet e kryera për llogari të Bashkisë si dhe detyrimet e pashlyera ndaj Bashkisë Tepelenë, sipas akt-rakordimit me Sha Ujësjellës Kanalizime Tepelenë paraqiten në tabelën mëposhtë:

NR	MUAJI	TË ARDHURA	LIKUJDIME PËR BASHKINË	DEBTORË 2022	SHTESA DEBTORË 2023
1	Janar - Dhjetor 2016	1,039,800	-	1,039,800	
2	Janar - Dhjetor 2017	1,037,020	541,998	495,022	
3	Janar - Dhjetor 2018	1,593,534	-	1,593,534	
4	Janar - Dhjetor 2019	1,553,103	-	1,553,103	
5	Janar - Dhjetor 2020	3,979,274	500,000	3,479,274	
6	Janar 2021	332,220	332,220	-	
7	Shkurt 2021	320,371	320,371	-	
8	Mars - Dhjetor 2021	4,066,843	-	4,066,843	
9	Janar - Dhjetor 2022	4,169,582	-	4,169,582	
10	Tetor - Dhjetor 2022 dhe Janar - Dhjetor 2023	2,785,790	-		2,785,790
	TOTALI	18,091,747	1,694,589	19,182,948	

Nga Sha Ujësjellës Kanalizime Tepelenë nuk ka bashkëpunim me Bashkinë Tepelenë për shkëmbimin e të dhënave në lidhje me numrin e kontratave të lidhura me kryefamiljarët, sa nga këto i përkasin fashës së përjashtuar nga taksimi, sipas dispozitave ligjore dhe sa familje janë debitorë nga mospagesat e detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrimit. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë nuk ka një regjistër. Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk

është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitore dhe vlera totale që ato kanë ndaj Bashkisë.

- Në Njësiti Administrative, për banesat te cilat nuk janë të lidhura me rrjetin e Ujësjellësit, taksa e banesës, tarifa e ndriçimit, gjelberimit nuk faturohet dhe nuk është mbledhur nga Bashkia Tepelenë.

- Nga Administratorët e Njësive Administrative dhe punonjësit e taksave nëpër NJA nuk është kryer asnjë përpjekje dhe punë për evidentimin e familjeve që janë abonentë me Ujësjellsin dhe ato që nuk kanë kontrata me Ujësjellsin, si dhe sa familje nga ato të rregjistruara në Gjendjen Civile jetojnë në fshatra., duke krijuar një database për tatimpaguesit me të dhënat e duhura për ngarkesën dhe faturimin me taksa dhe tarifave, detyrim ligjor për tu paguar nga taksapaguesit për njësinë vendore në këmbim të shërbimeve që marrin nga shërbimet e Bashkisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë” i ndryshuar, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117³.

Taksa mbi tokën bujqësore

Taksa mbi tokën bujqësore llogaritet në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23⁴.

Sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, Bashkia Tepelenë klasifikohet në kategorinë e VII-X ku çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në tabelën mëposhtme:

Kategoria e tokës bujqësore	Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas VKB-ve (lekë/ha/vit)
I	2,800
II	2,100
III	1,400
IV	1,350
V	1,250
VI	1,200
VII-X	1,100

Nga auditimi konstatohet se, në Bashkinë Tepelenë familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore si dhe Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet zotërojnë

³Neni 117 “Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave”

Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme:

a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.

b) Gjobë në masën 50 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës në rast se nuk mban tatimin në burim apo tatimin apo nuk mbledh taksën ose tarifën;

c) Gjobë në masën 100 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës nëse mban dhe nuk deklaron e paguan tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën e mbledhur.

⁴Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, aneksi 1.

me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe planifikohen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, Aneksi 1.

Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet, kur fermerët paraqiten në bashki apo NJA në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifave vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Sektori i Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokës me vlerë 1,100 lekë/ha/vit, kur bashkia ka të dhëna.

Nga NJA nuk disponohen regjistrat e saktë të tokës me të dhënat e sipërfaqeve dhe cilësisë së tokave (kategorizimi), si dhe marrëdhëniet juridike më të, pra statusi i pronësisë për të gjitha familjet fermere, gjë që është e domosdoshme për të patur të dhëna të sakta për bazën e taksueshme dhe për një planifikim të taksës së tokës mbi baza reale. Nga specialistët e tatimeve në NJA nuk ngarkoheshin familjet fermerë me taksën e tokës sipas kategorisë dhe nivelin e taksës përkatëse të përcaktuar në paketën fiskale.

Masat e marra për uljen e borxhit

Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tepelenë është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara.⁵

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Sektori i Tatim Taksave lidhur me zbatimin e hapave që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar bizneset debitorë sipas Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 4 pika 1 dhe 2, Ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 89, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24 datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore të Republikës së Shqipërisë”, pika 89, i ndryshuar. Pas kalimit të afatit për pagimin në mënyrë vullnetare të këtyre detyrimeve, Sektori i Tatim Taksave dhe janë dërguar në bankat përkatëse njoftimet:

- Nr. 1490 – 1490/14 prot., datë 06.12.2023, “Urdhër bllokimi i llogarive bankare”, për 15 subjekte;
- Nr. 249 – 249/14 prot., datë 06.12.2023, “Urdhër bllokimi i llogarive bankare”, për 15 subjekte;
- Nr. 2492 – 2492/14 prot., datë 06.12.2023, “Urdhër bllokimi i llogarive bankare”, për 15 subjekte;
- Nr. 2493 – 2493/14 prot., datë 06.12.2023, “Urdhër bllokimi i llogarive bankare”, për 15 subjekte;
- Nr. 2494 – 2494/14 prot., datë 06.12.2023, “Urdhër bllokimi i llogarive bankare”, për 15 subjekte.

Nga auditimit konstatohet se, pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet e vitit 2023, nuk janë nxjerrë urdhrat përkatës subjektet debitorë për të ndërmarrë hapa të tjera bazuar në masat e parashikuara në kuadrin ligjor të sipër cituar.

Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve

Në territorin e Bashkisë Tepelenë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë për vitin 2023, ushtrojnë këtë aktivitet 6 subjekte. Grupi

⁵Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 89, 90, 91, 93.

i auditimit auditori dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi⁶ dhe pagesën e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore për vitet 2023.

Nga auditimi konstatohet se, nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 6 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, të 6 subjektet kanë detyrime në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4 “*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*”. Neni 20-Autorizimet pika 2. “*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtarinë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11⁷, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*”. Detyrimet e krijuara nga subjektet që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë kanë **një efekt financiar me vlerë totale 3,750,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Tepelenë**, sipas tabelës mëposhtë.

lekë

Nr	Operatori Ekonomik	NIPTI	Autorizimi Bazë	Detyrime për t'u paguar	Pagesa viti 2021-2023	Debitor
1	O. ShPK	J.	03.08.2018-02.08.2023 03.08.2023-02.08.2028	2,020,000	820,000	1,200,000
2	B. ShPK	J.	08.05.2015-07.05.2020	1,100,000	800,000	300,000
3	K. ShPK	K.	25.02.2020-24.02.2025	1,000,000	800,000	200,000
4	K.ShPK	J.	05.06.2023-04.06.2028	1,000,000	200,000	800,000
5	S.ShPK	K.	08.07.2019-06.07.2024	1,000,000	200,000	800,000
6	A. ShPK	K.	30.06.2020-29.06.2025	1,100,000	650,000	450,000
				7,220,000	3,470,000	3,750,000

Debitorët Progresiv 31.12.2023

⁶Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20, pika 2.

⁷Ligji nr. 8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 11 Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë”.

Nr.	Emërtim i taksës/tarifës vendore	Kategoria e taksapaguesit	Numri i debitorëve	Vlera progresive e debitorëve në datën 31.12.2022, raportuar nga subjekti në auditimin e mëparshëm (të kryer gjatë vitit 2022)	Pagesat e kryera gjatë vitit 2023 për llogari të gjendjes së debitorëve progresiv në datën 31.12.2023	Vlera e debitorëve të rinj, krijuar vetëm gjatë vitit 2023, nga mos pagesa e detyrimeve të vitit 2023	Detyrimi progresiv i debitorëve më 31.12.2023
1	Qira tokë bujqësore		9	816,212			816,212
2	Taksë toke bujqësore	Familjar					
3	Debitorë B i Vogël	Privat	228	8,836,116	1,460,655	2,552,085	9,927,546
4	Debitorë B i Madh	Privat	61	10,922,734	1,082,741	1,696,578	11,536,571
5	Institucione		6	622,468		147,180	769,648
6	Debitorë taksë ndërtese, truall, pastrim, ndriçim	Familjar	2559	15,315,981		1,127,671	16,443,652
7	Debitorë ALUIZNI		61	2,078,937	19,290	37,912	2,097,559
8	Ujësjetës Kanalizime 2023					2,785,790	2,785,790
TOTAL			2 924	38,592,448	2,562,686	8,347,216	44,376,978

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

- Z. G. G., Përgjegjës i Sektorit të Tatim Taksave
- Z. L. B., Drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

3. AUDITIM MBI VLERËSIMIN E RAPORTIMIT FINANCIAR, PËR TË ARRITUR NË OPINIONIN NË SE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2022, JAPIN NJË PARAQITJE TË VËRTETË E TË DREJTË TË POZICIONIT FINANCIAR, PERFORMANCËS FINANCIARE DHE FLUKSIT TË PARASË, BAZUAR NË KUADRIN RREGULLATOR NË FUQI.

Për auditimin e kësaj pike u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Pasqyrat financiare të vitit 2023 të shoqëruar me formatet 1-9.
- Dokumente kontabël si: ditaret e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
- Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2023, libri i aktiveve.
- Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2023.
- Akt-rakordimet me Degën e Thesarit Tepelenë në mbyllje të vitit buxhetor 2023.
- Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet “excel”si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për ditaret, shpenzimet të ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2023 nga njësia shpenzuese “Aparati i Bashkisë Tepelenë” për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, Udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.

Bashkia Tepelenë për vitin 2023 nuk ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi nuk ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete, pasi Agjencia e Shërbimeve Publike dhe Drejtoria e Arsimit Kulturës i janë bashkuar Aparatit të Bashkisë në vitin 2020.

Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Tepelenë për vitin ushtrimor 2023 me shkresë përcjellëse nr.prot.358 datë 14.02.2024. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Kryetari i Bashkisë Tepelenë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi i Financës. Pra në këtë rast nuk kemi delegime të detyrave.

Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditaret kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel"
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj .Eshhtë mbajtur centrilizator për

evidentimin e veprimeve kontabël të kryera , duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përkrahja me vërtetuesi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim

Përkatësia: Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar, Saktësia: Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme

Periudha: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël, Klasifikimi: Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

Ligjshmëria dhe rregullsia: Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion

Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës

Ekzistenca: Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.

Të drejtat dhe detyrimet: Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

Plotësia: Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë regjistruar, dhe detyrimet janë regjistruar të gjitha në mbyllje të vitit ushtrimor, pra janë të paraqitura të plota në bilanc..

Vlerësimi dhe alokimi: Aktivitetet, pasivitetet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese

Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet: Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

Plotësia: Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

Klasifikimi dhe kuptueshmëria: Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura.

Saktësia dhe vlerësimi: Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Konkluzion: Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë 520 “Disponibilitete në Thesar” dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”

Totali i Aktivit për vitin 2023 është në vlerën 2,434,164,978 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Formati nr.1 Aktivi i Bilancit 2023 Në lekë

Nr.	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi i mbyllur	Ushtrimi paraardhes
1	A	A K T I V E T	2,736,240,245	2,434,164,978
2		I.Aktivet Afat shkurtra	220,409,497	197,105,981
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	19,652,145	14,411,297
4	531	Mjete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	19,652,145	14,411,297
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	25,604,836	18,615,766
12	31	Materiale	7,435,068	1,411,158
13	32	Inventar I imet	18,169,768	17,204,608
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari te Arketushme	141,278,323	137,905,534

22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	1,254,774	1,254,774
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shogerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	153,584,876	150,593,337
33	4342	Operacione me shtetin(Te drejta)	27,529,213	27,147,963
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)	-41,090,540	-41,381,911
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	33,874,193	26,173,384
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	33,874,193	26,173,384
42		II.Aktivet Afat gjata	2,515,830,748	2,237,058,997
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	352,003	352,003
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	352,003	352,003
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	2,336,319,642	2,236,706,994
48	210	Toka, T,roje, Terene	300,575,585	269,805,883
49	211	Pyje, Plantacione	935,577,632	834,513,598
50	212	Ndertesa e Konstruksione	296,006,050	312,012,841
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	780,257,091	793,031,633
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	6,028,917	6,254,800
53	215	Mjete Transporti	5,173,571	6,466,964
54	216	Rezerva Shteterore	0	0
55	217	Kafshe pune e prodhimi	0	0
56	218	Inventar ekonomik	12,700,796	14,621,275
57	24	Aktive afatgjata te demtuara	0	0
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata	0	0
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		4.Investime	179,159,103	0
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	179,159,103	

AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 19,652,145 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “ Teprica e likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” të paraqitur në Aneks.

- Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”, sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 19,652,145 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-

rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 “Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2023”.

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 25,604,836 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 18,615,766 lekë, ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej 6,989,070 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” në formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare”. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- Gjendja e llogarisë 31 “Materiale” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 7,435,068 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,411,158 lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 6,989,070 lekë, e cila përfaqëson paksim të gjendjes së mallrave ne fund te vitit 2022.

- Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 18,169,768 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 17,204,608 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 965,160 lekë, e cila përfaqëson rritje te inventarit te imët per vitin 2023.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 141,278,323 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 137,905,534 lekë, ku kemi shtese duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes se detyrimeve te debitorëve të ndryshëm .

- Gjendja e llogarisë 423, 429 “Personeli, paradhënie, deficite dhe gjoba” në aktiv të bilancit paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,254,774 lekë, vlerë cila përfaqëson debitorë për detyrime të lëna nga ish-Auditi i Prefekturës për paradhënie dieta për punonjësit e Bashkisë Tepelenë, që në vitet e hershme para vitit 2010. Për gjendjen e kësaj llogarie ekziston lista e ish-punonjësve debitorë, të cilët janë të larguar apo nuk ka adresë. Në këtë situatë këta debitorë janë pa shpresë arkëtimi, pasi përveçse mungojnë të dhënat për ta, por edhe ka kaluar koha e kërkimit dhe ndjekjes së procedurave ligjore për realizmin e arkëtimit të vlerës së këtyre detyrimeve.

- Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 153,584,876 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 150,593,337 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2022 ka pësuar një rritje prej 2,991,539 lekë, e cila i përket debitorëve të krijuar gjatë vitit 2023 nga taksat dhe tarifatat vendore. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të krijuar nga detyrimet e lindura nga rekomandimet “shpërblim dëmi” të lëna nga KLSH në vite në vlerën 84,992,244 lekë, që zënë 55% te vlerës debitore. Debitorët nga taksat dhe tarifatat vendore në vlerë progresive prej 22,226,565 lekë. Pjesa tjetër janë të drejtat të konstatuara nga të tretët për detyrime për gjoba IVMT, për taksën në infrastrukture nga legalizimet, nga Ujësujtësi si agjent tatimor, nga detyrime kontraktore për qiradhënie etj. Gjithashtu në vlerë të konsiderueshme janë dhe debitorët pa shpresë arkëtimi prej 24,718,646 lekë, për të cilët nuk ka dokumentacion mbështetës dhe adresim, dhe i përkasin një periudhe të hershme mbi 10 vjet. Analiza e gjendjes së llog.468 “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

nr	Emërtimi në zëra	Gjendje 31.12.2022	Sistemime (shitesa)	Shtuar gjate vitit ushtrimor	Sistemime (pakesime)	Pakesuar gjate viti ushtrimor	Gjendje 31.12.2023
1	Gjoba IVMT	2,290,000					2,290,000
2	Klsh	84,992,244					84,992,244
3	Legalizim	2,078,936		37,912		19,291	2,097,557
4	Zyra e tatimeve	20,381,318		4,388,643		2,543,396	22,226,565
	Biznesi I vogel		8,327,127	2,370,997	1,369,638	9,328,486	
	Bznesi I madh		10,922,734	1,689,378	1,082,741	11,529,371	
	Institucione		622,468	147,180	-	769,648	
	Nj.qender		508,989	181,088	91,017	599,060	
5	Ujesjellesi Agjent tatimor	15,315,981		1,127,671			16,443,652
6	Detyrime ne pamundes arketimi	24,718,646					24,718,646
7	Kontratat	816,212					816,212
	TOTALI llog 468	150,593,337		5,554,226		2,562,687	153,584,876
II	Debitore te tjere	1,254,774					1,254,774

Konkluzion: Në gjendjen prej 153,584,876 lekë të llogarisë 468 “Debitore të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023 nuk është përfshirë vlera pjesore prej 2,785,790 lekë e pa derdhur nga Ujësjetllës-Kanalizime e taksave dhe tarifave vendore të mbledhura nga taksapaguesit si detyrim I vitit 2023, pasi ka ardhur shkresa e konfirmim/rakordimit në vitin 2024 pas mbylljes të veprimeve kontabël të vitit ushtrimor. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 32, Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” ,Pika 3.3

- Gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 27,52 9,213lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2023, që trashëgohen në vitin 2024. Kjo gjendje ka në analizë ose përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-404 “Furnitorë e llogari te lidhura me to” në vlerën 4,973,015 lekë, llog.42“Detyrime ndaj personelit” për vlerën 12,398,209 lekë, llog.431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” për vlerën 1,736,624 lekë, llog.435 “Sigurime shoqërore” për vlerën 3,654,183 lekë, llog.436 “Sigurime shëndetësore” për vlerën 515,396 lekë dhe vlerën pjesore prej 4,251,786 lekë të llog.467"Kreditorë të ndryshëm" të planifikuar për likuidim në vitin 2023. Gjendja e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)” pasqyron detyrimet afatshkurtra, duke u debituar në kredi të llogarive kundërparti në pasiv të Bilancit, pasi kjo llogari përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për mbulimin me fonde në vitin pasardhës të shpenzimeve të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara.

- Gjendja e llogarisë 49 "Shumat e parashikuara për zhvlerësime" në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën - 41,090,540 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën - 41,090,540 lekë, vlerë e cila përfaqëson vlerë e cila përfaqëson detyrimet e debitorëve të krijuar mbi 10 vjet nga rekomandimet e dhëna nga auditimet e Prefekturës dhe KLSH, (në këtë vlerë nuk përfshihen debitorët për taksa e tarifa vendore dhe qiradhëniet) të vlerësuar pa shpresë arkëtimi për mungesë adresimi si dhe të gjobave për kundravajtje me tejkalim të afatit të parashkrimit, sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

- Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 33,874,193 lekë, vlera e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 38,125,979 lekë. Për detyrime të prapambetura ndaj të tretëve debitohet llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në kredi të llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, ku vlera e mosrakordimit prej 4,251,786 lekë përfaqëson detyrimet ndaj të treteve të krijuara në dhjetor të vitit ushtrimor 2023, që nuk u ka kaluar afati 30 ditor i pagesës dhe pritet të paguhet në janar të vitit pasardhës 2024.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve afatgjata materiale, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata materiale në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata materiale;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);

- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,106,059,234 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,237,058,997 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,303,909,007 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,666,913,128, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej 352,003 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 352,003 lekë. Kjo llogari i përket projektit “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale” vlerë e shtuar gjatë vitit 2022, për të cilën nuk është llogaritura amortizim në masën 15% në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 36 e cila përcakton se: “Për aktivet afatgjata jo materialë, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%”. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon.

Nr	Përshkrimi	Gjendje ne celje	Shtesa pa pagese	Gjithsej	Nxjerrje jashte perdorimit	Gjendje ne fund te ushtrimit
1	Studim mbyll, rehabilit mbetje urban nga venddepozit ilegal	352003		352003		352003
	Llogaria 202 :Studime e kerkime"	352003		352003	0	352003

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2023.

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,237,058,997 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,336,671,645 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqiten në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,666,913,128 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,830,216,270 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

- Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 300,575,585 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 269,805,883 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” si në mbyllje të vitit 2023 është 300,575,585 leke dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 269,805,883 lekë, pasi ka shtesa gjatë vitit 2023 ne shumen prej 30,769,702 lekë për shkak të shpronësimeve. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabel i llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” me datë 31.12.2022

Nr	Përshkrimi	Gjendje ne celje te ushtrimit 2023	Shtesa gjatë 2023	Pakësim e gjatë 2023	Gjendje ne fund te ushtrimit 2023
----	------------	------------------------------------	-------------------	----------------------	-----------------------------------

1	Parqe, lulishte	250,910	0	0	250,910
2	Reabilitim ambiente publike	2,879,803	0	0	2,879,803
3	Sistemim ambiente publike	3,279,917	0	0	3,279,917
4	Kendi lojrave (Nga Uji Ftohte)	1,367,858	0	0	1,367,858
5	Toka troje terrene (nga shpronesimet)	195,232,105	30,769,585	0	226,001,807
6	Peme dekorative	204,600	0	0	204,600
7	Reabilitim sheshe	372,000	0	0	372,000
8	Ndertim sheshe e ambiente tjera	2,000,000	0	0	2,000,000
9	Sheshi kryesor+hyrja e kalase	48,997,956	0	0	48,997,956
10	Sheshi spitalit	15,220,734	0	0	15,220,734
	Llogaria 210 "Toka,troje,terrene"	269,805,883	30,769,585	0	300,575,585

Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 ne shumen prej 834,513,598 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 834,513,598 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" në mbyllje të vitit 2021 ne vleren 935,577,632 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 834,513,598 lekë. Shtesa prej 101,064,034 lekë ka rezultuar nga rregjistrimi i pronave ne ASHK. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në Aneks.

Inventari kontabel i llogarisë 211 "Pyje,plantacione " me datë 31.12.2022

Nr	Përshkrimi	Gjendja me 31.12.2022	Shtesa Viti 2023	Pakesime Viti 2022	Gjendja me 31.12.2023
1	Pyje,kullota,plantacione	834,317,398	101,064,034	0	935,381,432
2	Peme dekorative	196,200			196,200
	Llog. 211 "Pyje,kullota,plantacione"	834,513,598	101,064,034	0	935,577,632

- Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 296,006,050 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 312,012,841 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 438,534,581 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 436,066,935 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar aktive shtesë në vlerën 2,467,646 lekë nga rritja e AAGJM me pagesë si: rikonstruksion fasada lagja Demokracia kopshtesh, banja publike etj. dhe shtesë pa pagesë nga jashtë sistemit në vlerën 2,900,847 lekë, që përfaqëson kalimin kapital Bashkisë Tepelenë nga Ministria e Shëndetësisë "Rikonstruksioni godinave të Qendrave Shëndetësore". Pakësimet janë në vlerën 0 lekë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Aneks.

- Gjendja e Llogarisë 213"Rrugë, rrjete, vepra ujore" paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 780,257,091 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në 793,031,633 lekë, ku diferenca prej 12,774,542 lekë është amortizimi i llogaritur për vitin 2023. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,081,471,367 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,054,594,327 lekë. Gjatë vitit 2023 janë bërë shtesat në vlerën 60,917,040 lekë, e përbërë nga vlera pjesore e prej 58,810,987 lekë e blerjes së aktivitetit "Ndërtim Ujësjiellës Progonat-Dhemblan" dhe surpervizimi në vlerën 2,106,053 lekë, por ndërkohë kemi dhe pakësime në vlerën 30,040,000 lekë nga kalimi kapital i Ujësjiellësit të fshatrave Nivicë-Peshtan dhe Salari te Ujësjiellësi Gjirokastër. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Aneks.

- Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 6,028,917 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,254,800 lekë, ku diferenca është amortizimi i përlllogaritur i vitit ushtrimor për këtë grup aktivesh. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 12,608,947 lekë për të cilat ka inventar fizik. Në këtë grup aktivesh nuk ka as shtesa dhe as paksime për vitin 2023. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie paraqitet në Aneks.

- Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 5,173,571 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,466,964 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 22,605,689 lekë, gjë që tregon se nuk ka shtesa dhe pakësime gjatë vitit 2023. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2022 paraqiten në Aneks:

Inventari kontabel i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2022

Nr	Emërtimi i aktiveve llogaria 214	Gjendja me 31.12.2022	Shtesa Viti 2023	Pakësime Viti 2023	Gjendja me 31.12.2023
1	Makina (Autovetur	2,500,000			2,500,000
2	Automjet Punimesh (Eskavator)	3,132,000			3,132,000
3	Automjet tip BENZ TP619A	830,000			830,000
4	Automjet Tip MITSUBISH	1,998,200			1,998,200
5	Automjet tip Benz TP 2977	1,998,000			1,998,000
6	Automjet Zjarrfikës "Autobot MAN"	3,404,309			3,404,309
7	Automjet Teknologjike Pastrimi "VOLVO"	1,000,000			1,000,000
8	Mjet Shërbimi kamion "BENZ"	910,800			910,800
9	Mjet Zjarrfikëse kamioncine	959,880			959,880
10	Mjet zjarrfikës "MAN"	1,500,000			1,500,000
11	Automjet "IVEKO FIAT"	120,000			120,000
12	Mjet Teknologjik Pastrimi (blerje 2022)	4,252,500			4,252,500
	TOTALI	22,605,689		0	22,605,689

- Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 12,700,796 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 14,621,275 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 38,490,466 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 37,235,746 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 1,254,720 lekë e pajisjeve, për të cilat janë ndjekur procedurat financiare e ligjore për evidentimin e tyre.

- Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/a “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” të PF si më poshtë:

Nr. Refere Llogar	EMERTIMI	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historik	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	352,003	0	352,003	352,003				352,003		352,003
202	Studime dhe kerkime	352,003		352,003	352,003				352,003		352,003
21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	2,666,561,125	429,854,131	2,236,706,994	197,343,142	63,690,494	34,040,000	0	2,829,864,267	493,544,625	2,336,319,642
210	Toka,troje,Terene	269,805,883	0	269,805,883	30,769,702	0			300,575,585	0	300,575,585
211	Pyje,Kullota Plantacione	834,513,598	0	834,513,598	101,064,034	0			935,577,632	0	935,577,632

212	Ndertime e Konstruksione	436,066,935	124,054,094	312,012,841	2,467,646	18,474,437			438,534,581	142,528,531	296,006,050
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,054,594,327	261,562,694	793,031,633	60,917,040	39,651,582	34,040,000		1,081,471,367	301,214,276	780,257,091
214	Insta tekn,makin,pais,vegl pun	11,738,947	5,484,147	6,254,800	870,000	1,095,883			12,608,947	6,580,030	6,028,917
215	Mjete transporti	22,605,689	16,138,725	6,466,964	0	1,293,393			22,605,689	17,432,118	5,173,571
216	Rezerva shtetore	0	0	0	0				0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi	0	0	0	0				0	0	0
218	Inventar ekonomik	37,235,746	22,614,471	14,621,275	1,254,720	3,175,199	0		38,490,466	25,789,670	12,700,796
24	A. te Qend.te trupez te demtu	0	0	0	0				0	0	0
28	Caktime	0	0	0	0				0	0	0
T O T A L I (I + II)		2,666,913,128	429,854,131	2,237,058,997	197,343,142	63,690,494	34,040,000	0	2,830,216,270	493,544,625	2,336,671,645

- Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale paraqitet në bilanc në vlerën 493,544,625 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.

“Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara” është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36 Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Inventarizimi i aktiveve për vitin 2023 Bashkia Tepelenë

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2023 për Bashkinë Tepelenë dhe Njësite Administrative ne varësi.

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2023 ka dalë urdhri me nr.prot.144, datë 26.10.2023 “ Për kryerjen e inventarizimit të AQ , inventarit të imët dhe inventarit ekonomik dhe materialeve të magazinës” në bazë të këtij urdhri është përcaktuar komisioni I inventarizimit I përbërë nga 7 punonjës. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se, komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Aparatin e Bashkisë dhe për njësitë në varësi si Njësitë Administrative, 3 shkollat, kopshtet dhe cerdhet (qytet dhe fshat), Qendra Kulturore e Fëmijëve, Qendra e Kulturore (Muzeu dhe Pallati i Kulturës). Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2023 dhe rezultojnë pa diferenca. Është hartuar një relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku të përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit. Për vitin 2023 nuk janë nxjerre aktive afatgjata jashtë përdorimit.

Shtesa pa pagesë AAGJM dhe materiale nga FSHZH, dokumentimi dhe kontabilizimi i tyre, Lidhur me procedurën e prokurimit (marrëveshje kuadër), blerje e përqendruar për disa Bashki realizuar nga FSHZH, Bashkia Tepelenë ka aplikuar për nevoja furnizimi për projektin “Rrugë hyrëse fshati Dragot, Rrugë e brendshme qytet Tepelenë, Rrugë e brendshme fshati Mamaj, Rrugë e brendshme lagjia Majkosh, Rrugë e brendshme lagjia SMT”, projekt i cili mbulohet nga 3 Lote, si vijon:

Marrëveshjes Kuadër nr. 3108 Prot., datë 11.10.2022 me objekt: “Loti 1 - Blerje materiale ndërtimi sipas kërkesave të Bashkive.”							
Kontrata	F.limit/pa tvsh	kontrata pa tvsh	kontrata me tvsh	Afati MK	Dt. E fillimit MK	Dt.perfund	OE fitues

Mbështetje me furnizim materiale ndërtimi me lëndë të parë, për realizimin e punimeve për projektin: “Rrugë hyrëse fshati Dragot, Rrugë e brendshme qytet Tepelenë, Rrugë e brendshme fshati Mamaj, Rrugë e brendshme lagjia Majkosh, Rrugë e brendshme lagjia SMT(Sorodol)”, Bashkia Tepelenë	4,565,544.70	4,565,544.70	5,478,653.64	24.00	11.10.2022	1.10.2024	V.
--	--------------	--------------	--------------	-------	------------	-----------	----

Marrëveshjes Kuadër nr. 2348 Prot., datë 15.08.2022 me objekt: “Loti 3 - Blerje Materiale për ujësjellës kanalizime sipas kërkesave të Bashkive

Kontrata	F.limit/pa tvsh	kontrata /pa tvsh	kontrata - Vlera/me tvsh	Afati MK	Dt. E fillimit MK	Dt,perfund	OE fitues
Mbështetje me furnizim materiale ujësjellës kanalizime KUZ, për realizimin e punimeve për projektin: “Rrugë hyrëse fshati Dragot, Rrugë e brendshme qytet Tepelenë, Rrugë e brendshme fshati Mamaj, Rrugë e brendshme lagjia Majkosh, Rrugë e brendshme lagjia SMT(Sorodol), Bashkia Tepelenë	4,058,100.00	4,058,100.00	4,869,720.00	24.00	15.08.2022	5.08.2024	A.

Marrëveshjes Kuadër nr. 2349 Prot., datë 15.08.2022 me objekt: “Loti 4 - Blerje Materiale mobilimi urban sipas kërkesave të Bashkive.

Kontrata	F.limit/pa tvsh	kontrata - Vlera/pa tvsh	kontrata - Vlera/me tvsh	Afati MK	Dt. E fillimit MK	Dt,perfund	OE fitues
Mbështetje me furnizim materiale urbane, për realizimin e punimeve për projektin: “Rrugë hyrëse fshati Dragot, Rrugë e brendshme qytet Tepelenë, Rrugë e brendshme fshati Mamaj, Rrugë e brendshme lagjia Majkosh, Rrugë e brendshme lagjia SMT(Sorodol), Bashkia Tepelenë	6,311,000.00	6,311,000.00	7,573,200.00	24.00	15.08.2022	15.08.2024	L. K.N” sh.p.k

Për sa më lart, Bashkia Tepelenë ka nënshkruar Marrëveshjen e Furnizimit me FSHZH me nr. 1327/1, datë 07.04.2023 me sasi të nevojshme të materialeve në zbatim të projektit. Me urdhër nr. 66, datë 05.04.2023 të titullarit të Bashkisë, është ngritur grupi i punës për marrjen në dorëzim të materialeve të furnizuara. Marrja në dorëzim është bërë siaps operatorëve ekonomik që do të kryejn furnizimin, në prani edhe të përfaqësuesit të FSHZH dhe konkretisht me procesverbal datë 13.04.2023 dhe datë 14.04.2023 për materialet e dorëzuara nga A. shpk, me procesverbal datë 14.04.2023 dhe datë 17.04.2023 nga L. C. shpk dhe me procesverbal datë 26.05.2023 nga V. shpk. Materialet e furnizuara janë bërë hyrje në magazinë në momentin e marrjes në dorëzim shoqëruar me faturat përkatëse dhe dalje në momentin e përdorimit si vijon:

Me fletëhyrje nr. 25, datë 12.04.2023 janë bërë hyrje 71.3ML Tuba fi 1000 në vlerën 654,534 lekë; Me fletëhyrje nr. 26, datë 13.04.2023 janë bërë hyrje Tubo të brinjëzuar në vlerën totale 4,215,186 lekë;

Me fletëhyrje nr. 27, datë 13.04.2023 janë bërë hyrje stola të ndryshëm dhe kosha në vlerën 7,111,200 lekë;

Me fletëhyrje nr.28, datë 17.04.2023 janë bërë hyrje stola betoni me vlerën 462,000 lekë;

Me fletëhyrje nr.39, datë 26.05.2023 janë bërë hyrje çimento, hekur betoni, pllaka dhe bordura.

Pas daljes nga magazina, materialet u janë dhënë në dorëzim Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ndërmarrjes së gjelbërimit apo Njësi Administrative sipas objekteve të punimeve për realizimin e tyre.

Nga auditimi rezulton se gjatë vitit 2023 Bashkia Tepelenë ka realizuar shpenzime për blerje materiale të ngjashme, por që janë shpenzime të kryera për objekte të tjera punimesh të ndryshme nga ato të aplikuara në marrëveshjen me FShZH.

Konkluzion: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2023 në vlerën 2,829,864,267 lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në fund të vitit 2022 në llogaritë: 210 “Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 300,575,585 lekë; 211 “Pyje, Plantacione” në vlerën 935,577,632 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksiione” në vlerën 438,534,581 lekë; 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 1,081,471,367 lekë; 214“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 12,608,947 lekë. Në këto inventare ka në ndonjë rast në çdo grupaktivësh emërtesa të paplota si dhe janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, sipas amërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv për një pjesë të AAGJM si dhe, sic duhet ti ketë të evidentuar një regjistër format i plotë i aktiveve në mospërputhje me UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” kapitulli III, pika 30 dhe me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” kapitulli II, pika 11, aneksi 1, pika 2 Klasa 2, dhe me Nomenklaturën e Llogarive të planit kontabël publik.

- Gjendja e llog. 231“Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2023 paraqitet në vlerën 179,159,103 lekë, ku sipas analizës rezulton që kjo llogari paraqet vlerën pjesore të paguar të kontratave të investimeve që janë në vazhdim të pa kapitalizuar. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	Emërtimi I investimeve në proces	Vlera
1	Ndertim Ujesjellesi Progonat - Dhemblan	0
2	Ndertim ujsjellesi Nivice - PESHTAN	88,034,347
3	Rikonstrukcion Ujesjellesi fshati SALARI	20,856,000
4	F.v matesa ne kollone	14,792,861
5	Rikonstrukcion shkolla 9 VJECARE “Avni Rustemi”	55,475,895
	SHUMA II	179,159,103

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

në lekë

Nr.Re shti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur 2023	Ushtrimi Paraardhës 2022
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	191,578,541	170,890,087
66		I.Pasivet Afat shkurtra	191,578,541	170,890,087

67		1. Llogari te Pagushme	191,578,541	170,890,087
68	401-408	Furnitore e llogari te lidhura me to	4,973,015	5,544,358
69	42	Detyrime ndaj personelit	12,398,209	9,224,232
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1,736,624	501,183
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqerore	3,654,183	2,570,834
76	436	Sigurime Shendetsore	515,396	351,714
77	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	16,426,025	12,812,451
82	467	Kreditore te ndryshem	38,125,979	28,229,661
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime)	113,749,110	111,655,654
84	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
85		2.Te tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,544,661,704	2,263,274,891
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,544,661,704	2,263,274,891
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	2,541,435,584	2,255,674,763
99	12	Rezultatet e mbartura		6,001,282
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	3,226,120	1,598,846
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	2,736,240,245	2,434,164,978

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 191,578,541 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarie në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,973,015 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 5,544,358 lekë, vlerë

e cila ka ardhur në ulje, duke paguar faturat e palikujduara për mallra, shërbime dhe investime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se, përbëhet nga 11 fatura të palikujduara ndaj të tretëve, borxh i krijuar në nëntor-dhjetor të vitit 2023, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e gjendjes së llog.401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”

Nr	Operatori ekonomik	Data e fatures	Shuma Në lekë
1	L. 2. shpk	31.12.2023	360,000
2	C. Sha	31.12.2023	540,212
3	O. shpk	31.12.2023	770,736
4	E. B.	31.12.2023	774,000
5	O. Dh.	31.12.2023	100,000
6	L. D.	31.12.2023	118,896
7	I.B.	31.12.2023	35,599
8	D. A.	31.12.2023	564,500
9	3. shpk	31.12.2023	373,999
10	J. & Sh.	31.12.2023	658,800
11	S. X.	31.12.2023	702,285
	Detyrimi me datë 31.12.2023		4,973,015

- Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 12,398,209 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2023.

- Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën kontabël 1,736,624 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën 3,654,183 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

- Gjendja e llogarisë 436 “Sigurime shëndetësore” në fund të vitit 2023 është në vlerën kontabël 515,396 lekë.

- Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet si në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 113,749,110 lekë, e cila rakordon me gjendjen e debitorëve në llogaritë e klasës 4 në aktiv të bilancit në vlerën 113,749,256 lekë përkatësisht: (gjendja e llog.468 "debitorë të ndryshëm" në vlerën 153,584,876 lekë + gjendja e llog.423-429 "Personeli, paradhënie, deficite, gjoba" në vlerën 1,254,774 lekë - gjendja e llog.49 "Shuma të parashikuara për zhvlerësim" në vlerën 41,090,540 lekë).

- Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 12,812,451 lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Tepelenë,

Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 38,125,979 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 28,229,661 lekë me një diferencë në rritje prej 9,896,318 lekë në krahasim me vitin 2022.

Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”

Nr	Operatori ekonomik	Shuma Në lekë	Nr	Operatori ekonomik	Shuma Në lekë
1	I. S.	235,200	17	Ë. G.	527,990
2	I.	212,400	18	A. J.	98,800
3	B.	399,999	19	K. M.	85,160
4	M. V.	586,560	20	F. M.	744,000
5	Xh. K.	102,400	21	E.	25,200
6	S. A.	1,377,120	22	G. A.	100,000
7	F. R.	95,000	23	S.	71,156
8	A.	180,000	24	F.SH.U	8,316,682
9	S.	300,000	25	Sh. Ujsjelles - Kanalaizime	4,747,192
10	Sh.L. V.	442,200	26	Posta Sh.a	820,771
11	B. C.	918,730	27	P. Sh.(vend. Gjyqesor)	122,999
12	V. M.	100,000	28	Sh. sh.p.k	- 4,983,229
13	A. K.	137,400	29	A.	462,000
14	S. Xh.	4,774,353	30	N.	119,952
15	Ç. Sh.	806,540	31	N.	119,520
16	O. sh.p.k	5,568,326	32	S.	545,100
				Detyrimi me datë 31.12.2023	33,874,193

Observacioni i sjellë me shkresën 872/10, datë 27.06.2024, protokolluar në KLSH me nr.prot.620/3, datë 28.06.2024

Pretendimet e subjektit të audituar.

-Nuk kemi dublim të vlerës për faktet e mëposhtme:

Në llog. 401-404 “furnitorë e llogari të lidhura me to” në vlerën 4,973,015 lekë janë pasqyruar faturat të cilat nuk kanë kaluar afatin 30 ditor në institucion dhe nuk konsiderohen detyrime të prapambetura.

Në llog. 467 “Kreditorë të ndryshëm” vlera 38,125,979 lekë përbëhet nga vlera 33,874,193 lekë që përfaqësojnë detyrimet e prapambetura dhe 4,251,786 lekë detyrime të lindura rishtazi brenda afatit 30 ditor por që kanë të bëjnë me shërbime të ndryshme dhe pasqyrohen në këtë llogari.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Në lidhje observacionin e subjektit sqarojmë se, merren në konsideratë pas sjelljes së analizës së saktë të llogarisë 401-404 “Furnitorë e llogarive të lidhura me to” dhe është reflektuar në raportin përfundimtar të auditimit.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim, sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” të PF të vitit 2023 paraqitet në Aneks.

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 387,150,069 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Tepelenë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike⁷⁰ “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 14,294,704 lekë, i cili kuadron me aktrakordin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike 7002 “Tatim mbi Biznesin e vogël” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,974,635 lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 4,974,635 lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë 7035 “Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie” pasqyrohet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 8,172,296 lekë e cila përfshin taksa e pastrimit, gjelbërimit, ndriçimit, zënie hapësire publike, qiratë për truallin.etj.

- Gjendja e llogarisë 71 “Të ardhurat jo tatimore” paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 21,191,260 lekë, i cila kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë 7109 “Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 7,020,223 lekë, e cila përfshin taksën e ndikimit në infrastrukturë, taksën e tokës, qiratë nga kullotat dhe nga pyjet i cili kuadron me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

b. Gjendja e llogarisë 711 “Shërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare” paraqitet në bilancin e 2023 në vlerën 9,116,814 lekë, e cila përfshin tarifatat administrative, kamatëvonesa, tarifa shërbimesh, licenca etj. Kjo vlerë me aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” është në vlerën prej 27,529,213 lekë, vlerë e cila rakordon me gjendjen e llogarisë analoge 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” në aktivin e bilancit, pasi kjo gjendje pasqyron detyrimin, që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara

Analiza e shpenzimeve në vitin 2023, të cilat në total janë në vlerën 383,923,949 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’ për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 157,532,525 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 601 ‘Kontribute për sigurime’ për vitin 2023, paraqitet në bilanc në vlerën 16,212,267 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin.

- Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime” paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 84,206,617 lekë dhe sipa aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 88,430,609 lekë , diferenca – 4,223,992 leke.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korente te brendshme” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 6,146,527 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime per buxhetet familjare e Individë” paraqitet në bilanc për vitin 2023 në vlerën 119,188,218 lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.

Per vitin 2023 totali i te ardhurave ne vlere është 387,150,069 lekë dhe totali shpenzimeve eshte 383,923,949 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 3,226,120 rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit e ushtrimit”

Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2023 është në vlerën - 6,989,070 lekë.

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”

- Zeri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 622,920,970 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 311,460,485 lekë fonde të akorduara për investime, vlera prej 132,301,382 lekë investime të dhuruara në natyrë.

Nga testi kontrollit për vitet 2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. gjendja e arkës nuk e kalon limitin e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 geramat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Pagesat e kryera jashtë afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës.

Konkluzion: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në 50 raste faturash me vlerë 43,646,548 lekë, mbi afatin 30 ditor të faturave për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Tepelenë, ku 48 raste në vlerën 20,846,548 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 "shpenzime operative" dhe në 2 raste në vlerën 22,800,00 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 "investime", ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Likuidimi me vonesë i faturave në tejkallim të afatit ligjor prej 30 ditësh është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e

sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 528, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”. Rastet më konkretisht paraqiten në Aneks.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. S. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe zj.K. S. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës.

4. AUDITIM MBI ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E STRUKTURAVE MBI ADMINISTRIMIN E PRONËS PUBLIKE (ASETE DHE PYJE E KULLOTA) TË TRASNFERUARA SIPAS VKM.

Në zbatim të pikes 4 të programit të auditimit: “*Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Asete dhe Pyje Kullotave) të trasnferuara sipas VKM*” u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Inventarët e aseteve të kaluara me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror.
2. Listat e aseteve të kaluara në pronësi të Bashkisë së bashku me certifikatat hipotekore, si dhe lista e aseteve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për pajisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asete.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Asetet e kaluara nga pushteti qendror pranë Bashkisë Tepelenë paraqiten, sipas VKM-ve

- Për **Bashkinë Tepelenë** (Bashkia Qendër) është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë, me VKM nr. 6, datë 06.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë të Qarkut të Gjirokastrës”, sipas lidhjes nr.1 me 181 fletë, përfundon me numër rendor 1367 dhe përmban 1112 prona të trasnferuara.
- Për **Komunën Qendër Tepelenë** është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë me VKM nr.843, datë 06.12.2021 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Qendër, Qarku Gjirokastrë” Lista e inventarit me 159 fletë përfundon me numrin rendor 1111 dhe përmban 577 prona.
- Për **ish Komunën Kurvelesh** është miratuar lista përfundimtare e pronave me VKM nr. 386, datë 25.05.2011 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Kurvelesh, Qarku Gjirokastrë. Lista e inventarit me 82 fletë përfundon me numrin rendor 554 dhe përmban 262 prona.
- Për **ish Komunën Lopëz** është miratuar lista paraprake e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Tepelenë, me VKM nr. 380, datë 08.04.2009 “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike,

8në të cilën përcaktohet se: “Nëpunësit zbatues të njëjësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik.”

shtetëtoare, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Lopëz të Qarkut të Gjirokastrës”, sipas lidhjes nr.1 që përfundon me numër rendor 475 dhe përmban 357 prona.

Nga auditimi rezulton se referuar listave të miratuara të inventareve si më lart, Bashkia Tepelenë zotëron në total 2308 asete, nga të cilat për 1951 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake. Nga lista e aseteve të transferuara, rezulton se Bashkia Tepelenë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me çertifikatë në ZVRPP Tepelenë vetëm asete të llojit troje, kullota, ara, etj, dhe nuk konstatohet të jenë kryer aplikime apo regjistrime për asetet e llojit objekte. Deri në periudhën objekt auditimi, situata sa i takon regjistrimit dhe çertifikimit të aseteve të transferuara për Bashkinë Tepelenë, paraqitet në anekset bashkëlidhur.

Nga auditimi rezulton se nga 2308 asete në tërësi Bashkia Tepelenë ka regjistruar dhe pajisur me çertifikatë 214 asete me sipërfaqe 1,007 ha tokë të llojit pyje, kullota e ara, ose 7.2% të aseteve me vlerë kontabël të paraqitur edhe në bilanc prej 1,161,383,237 lekë. Ndërkohë që janë marra masa dhe është aplikuar për regjistrimin e 83 aseteve sipas anekseve bashkëlidhur.

Për asetet e tyre, Bashkia nuk ka kryer një inventarizim periodik, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre që pas kalimit në pronësi, nëse janë ende ekzistente apo të dëmtuara, të zaptuara rishtazi, privatizuara, etj.

Ndërkohë sa i takon aseteve të llojeve kullota/pyje transferuar sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, rezulton se Bashkisë Tepelenë i janë transferuar asete sipas shtojcës nr. 28, me numër rendor 1-688 si vijon:

Gjithsej **29’340** ha, nga këto:

- Pyje **8’950** ha,
- Kullotë **19’989** ha
- Toka joproductive **401** ha

Nga sipërfaqet e mësipërme rezulton se janë rregjistruar në AShK Tepelenë rreth 29’000 ha. Për pasuritë të cilat janë çertifikuar, bashkia Tepelenë ka përgatitur 3 plane menaxhimi/mbarështimi të miratuara nga Këshilli Bashkiak, dhe gjatë vitit 2024 është planifikuar mbarështimi për Ekonominë Pyjore Kurvelesh e cila është në fazën e prokurimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18, 22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, invenatrizimi, transferimi dhe rregjistrimi i pronave të paluajtshme publike”nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 ”Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”.

Nga asetet e mësipërme të pajisura me çertifikata pronësie, rezulton se Bashkia Tepelenë për periudhën objekt auditimi ka patur në fuqi 93 kontrata për dhënie me qira të këtyre sipërfaqeve,

nga të cilat 27 subjekte rezultojnë debitorë për vitin 2023 në vlerën 2,010,330 lekë sipas aneksit bashkëlidhur.

5. MBI AUDITIMIN E ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMIN E MËPARSHËM

Nga zbatim të programit të auditimit u verifikua dokumentacioni si më poshtë:

- Raporti Përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Tepelenë “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë”.
- Shkresa përcjellëse e Raportit Përfundimtar të Auditimit, dërguar nga KLSH me nr. 422/8 prot., datë 28.09.2023;
- Urdhrat e nxjerrë nga Titullari për zbatimin e rekomandimeve;
- Dokumentacioni i paraqitur mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna.

Nga verifikimi rezultoi se:

I. Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna.

- Me Urdhër nr. 137, datë 18.10.2023 të Titullarit të Bashkisë, është miratuar plani i veprimit dhe strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, i cili është dërguar në KLSH me shkresë nr. 2004/3, datë 18.10.2023 **brenda afatit 20 ditor** nga marrja e shkresës, në përputhje me nenin 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” sipas të cilit KLSH duhet të vihet në dijeni mbi marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, dërgon planin e veprimeve, duke përcaktuar pranimin e rekomandimeve të KLSH-së, ose refuzimin e zbatimit të rekomandimit në rastin e masës për shpërblim dëmi.

II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

- Bashkia Tepelenë në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe afatet e përcaktuara, ka dërguar raportimin përkatës me shkresë nr. 449, datë 29.02.2024 **brenda afatit 6 mujor**, në përputhje me pikën 2, të nenit 30 të Ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” .

Nga auditimi u konstatua, mungesë e gjurmës së raportimit në Këshillin Bashkiak të ecurisë të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 - Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, rezultoi se janë rekomanduar gjithsej 41 masa, të cilat janë pranuar plotësisht ose në masën 100%.

Nga 41 masat e rekomanduara dhe të pranuar janë zbatuar plotësisht 10 prej tyre ose 24.4%, në proces zbatimi 13 masa ose 31.7%, pjesërisht zbatuar 3 masa dhe pa zbatuar rezultuan 15 masa ose 36.5%.

Niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve për gjithsej 41 rekomandime për përmirësimin e situatës, është si më poshtë:

- Për përmirësimin e gjendjes janë lënë 27 masa organizative dhe janë pranuar plotësisht, nga të cilat, 9 janë zbatuar plotësisht, 13 masa në proces zbatimi, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 nuk janë zbatuar.
- Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), 1 masë në vlerën 188,311 lekë e pranuar dhe e zbatuar.
- 13 masa disiplinore, të cilat nuk janë zbatuar;

Më hollësisht, auditimi i ndjekjes së rekomandimeve paraqitet si vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1.Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë Tepelenë, me atributet e Kryetarit të GMS, si dhe Nëpunësit Autorizues dhe Koordinatorit të Riskut, të merren masa për njohjen nga stafi të ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. Të kryhen investime në programe kompjuterike të licencuara në shërbim të njësisë si dhe të kryhen procedura në drejtim të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Të hartohen dhe zhvillohen programe trajnimesh për ngritjen profesionale të stafit. Të sigurohen raportime të vazhdueshme nga menaxherët e programeve realizimin e objektivave mbi bazë produkti dhe impakti. Të vendoset një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Në vijimësi

Komenti: Nga auditimi u konstatua se Bashkia Tepelenë ka marrë masa për hartimin dhe miratimin e Strategjisë së Risqeve. Me shkresë nr. 413/1, datë 28.02.20224, është përgatitur raporti vjetor i cili informon punonjësit dhe menaxherët e lartë mbi realizimin e objektivave dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm. Në zbatim të rekomandimit janë përgatitur dhe shpërndarë pyetësorë të vetëvlerësimit të gjendjes së kontrollit të brendshëm në bashki dhe njësitë e varësisë.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

2.1. Rekomandimi: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse t'i jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

Në vijimësi

Komenti: Nga auditimi u konstatua se për vitin 2023 struktura për auditin e brendshëm ka funksionuar vetëm me një auditues për shkak të mungesës së burimeve njerëzore. Për këtë arsye është arritur të mbulohen me auditim vetëm një pjesë e fushave me risk të planifikuara, si p.sh. nuk konstatohen auditime mbi prokurimet publike.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i zbatuar**.

3.1. Rekomandimi: Strukturat drejtuese të Bashkisë Tepelenë, nëpërmjet Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar dhe në bashkëpunim me Menaxherët e Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent të jenë sa më të argumentuara, si dhe të kujdesen për realizimin e projekteve të investimeve të planifikuara. Shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Për uljen e borxhit në mënyrë të kontrolluar, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar të paraqesë në mbledhjen e Këshillit Bashkiak një material të plotë për gjendjen në fund të vitit ushtrimor të faturave të palikuiduara të prapambetura dhe të hartojë një grafik, duke zbatuar radhën e pagesave.

Në vijimësi

Komenti: Nga auditimi u konstatua se Bashkia ka përgatitur një planifikim buxheti sipas nevojave dhe mundësive financiare, duke realizuar edhe auditime mbi detyrimet e prapambetura për përmirësimin e situatës. Nga njësia e financës është vijuar puna për shlyerjen e tyre, për sa i takon atyre detyrimeve që arrihet të identifikohet origjina dhe kategorizimi. Për vitin 2023 ka rezultuar një realizim faktik buxheti në masën 96% çka nënkupton se është përmirësuar procesi i planifikimit dhe janë përmbushur objektivat në një masë të konsiderueshme.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

4.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2022, në vlerën 20,381,313 lekë. Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Tepelenë, për moskalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë. Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se sektori i taksave dhe tarifave vendore ka marrë masa për identifikimin dhe regjistrimin e të gjithë devitorëve, si dhe janë dërguar njoftimet për bllokime të llogarive në rast të mos pagesave të detyrimeve. Po kështu për vitin 2023 rezulton se 10 subjekte që kanë kaluar statusin pasiv, kanë shlyer detyrimet përkatëse.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

5.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe NJA, të marrë masa për krijimin e regjistrit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e kategorisë “familjare” me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë. Bashkia Tepelenë, bazuar në kontratën dypalëshe me agjentin tatimor UK Tepelenë SHA, të kërkojë prej këtij të fundit xhirimin e vlerës 16,397,158 lekë, në llogarinë përkatëse në degën e thesarit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka marrë masa për hartimin e regjistrit të familjarëve me të dhënat përkatëse për detyrimet e tyre tatimore. Ndërkohë

me shkresë nr. 988/18, datë 23.10.2023 i është drejtuar Shoqërisë UK Gjirokastër për arkëtimin e vlerës 16,397,158 lekë dhe në rast të mos kryerjes së likuidimit, do të vijohet me bllokimin e llogarive dhe masave të tjera administrative. Në përgjigje të kërkesës së mësipërme, UK Gjirokastër me shkresë nr. 2532/1, datë 14.02.2023, për shkak të vlerës së konsiderueshme të detyrimit ka propozuar likuidimin e vlerës së përqindjes (4%) si agjent tatimor dhe vijimin e shlyerjes së detyrimit për një periudhë afatmesme 2024-2026 në shumën 455,790 lekë/muaj. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

6.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë, të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve, referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Tepelenë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se sektori i taksave dhe tarifave vendore nuk ka marrë masa për hartimin e regjistrit të familjarëve që posedojnë toka bujqësore me të dhënat përkatëse për detyrimet e tyre tatimore.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pa zbatuar**.

7.1. Rekomandimi: Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Tepelenë të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitore për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për 70 debitorë në vlerën 10,620,347 lekë, si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Tepelenë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se vlera debitore prej 10,620,347 lekë lënë në auditimin e mëparshëm, në fund të vitit 2023 rezulton të jetë 2,097 mijë lekë, çka tregon se është arritur arkëtimi në masën 80%.

Për sa më lart rezulton se rekomandimi është **i zbatuar**.

8.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Tepelenë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës 3,708,676 lekë (principal dhe kamatëvonesë), e cila lind nga mospagesa e kontratave të qirasë për 16 subjekte qiramarrës, referuar kushteve të kontratave.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me Urdhër nr. 42, datë 22.02.2023 është ngritur komisioni për monitorimin në terren lidhur me zbatimin e termave kontraktor për kontratat me objekt mbjellje kulturash dhe respektimin e afatit për shlyerjet e detyrimeve financiare. Në vijim është ngritur edhe urdhri nr. 42/1, datë 22.02.2023 “Për përgatitjen dhe përmirësimin e kontratave me objekt qiradhënien e aseteve të Bashkisë”.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

9.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjektit B. ShPK dhe të marrë masa që ky subjekt të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Tepelenë për 5 vjet, që nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike dhe të prapambetura të autorizimeve për të gjithë subjektet: B. Shpk në vlerën 100,000 lekë, O. Shpk në vlerën 380,000 lekë dhe S.G. Shpk në vlerën 800,000 lekë, me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezulton se me shkresë nr. 988/17, datë 23.10.2023 është njoftuar subjekti Braka shpk për likuidimin e detyrimit, i cili është shlyer pjesërisht nëpërmjet arkëtimit në Bashki me mandat nr. 649, datë 25.10.2023 dhe pjesërisht në bankë më datë 12.01.2023, ndërkohë nuk rezulton të jenë marrë masa për shlyerjen e detyrimeve për 3 subjektet e tjerë.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i zbatuar**.

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë, të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktivesh afatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet t'i evidentojë ato në llogaritë 230-231 "Shpenzime në proces për rritjen e AQT" deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave, t'i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi që po kryhet aktualisht për pasqyrat financiare për vitin 2023, rezulton se është respektuar ky rregull. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë, të shqyrtojë veprimet kontabël të kryera në librat e kontabilitetit, për nxjerrjen e shkakut të deviacionit në vlerën 898,083 lekë të veprimeve ekonomike të ndodhura me debitorët në vite dhe më pas të kryhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet në llogaritë e klasës 4, duke i reflektuar përfundimisht në pasqyrat financiare të vitit 2023.

Brenda datës 31.03.2024

Komenti: Nga auditimi që po kryhet aktualisht për pasqyrat financiare për vitin 2023, rezulton se është sistemuar ky veprim. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

12.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (përjashtuar kufizimet e MFE), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim moskrijim borxhi për fatura të palikuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi i veprimeve të kryera gjatë vitit 2023, rezultoi se në masën më të madhe është respektuar ky rregull, megjithatë në pak raste është përsëritur ky fenomen. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

13.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet, ndërsa në shpalljen e OE fitues të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE të cilët nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën risk real për realizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga njësitë përgjegjëse të mësipërme marrjen e masave në funksion të hartimit të kriterëve të kualifikimit në përpjestim me natyrën e kontratës.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

14.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa që: - Të mos miratohen leje ndërtimi pa miratuar më parë lejen e zhvillimit dhe përcaktimin e kushteve zhvillimore. - Lejet e ndërtimit të miratohen përpara fillimit të punimeve të ndërtimit, të zhvillohet njoftimi i fillimit të punimeve dhe të mbahen aktkontrollat për fazat e ndërtimit që vijnë pas njoftimit të fillimit të punimeve, duke verifikuar konformitetin e tyre gjatë ndërtimit. - Lejet e ndërtimit të mos miratohen pa verifikuar paraprakisht mënyrën e aksesit në objektin që do të zhvillohet, gjurma e objektit të zhvillohet brenda kufirit të pronësisë për të cilën është zhvilluar aplikimi dhe në përputhje me dokumentacionet që vërtetojnë të drejtat pasurore të zhvilluesit. - Lejet e ndërtimit të miratuara, të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara midis ndërtimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga DPZHT Tepelenë marrjen e masave dhe mbajtjen parasysh për lejet në vijim të të gjithë mangësive të konstatuara nga auditimi.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

15.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të ruajtur dhe mbrojtur tokën bujqësore nga ndërtimet që nuk janë në përputhshmëri me kushtet e kontratës dhe planin e biznesit të miratuar në dhënien me qera të tokës bujqësore të pandarë.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga DPZHT Tepelenë marrjen e masave për zbatimin e kushteve të kontratës për dhënien me qera të tokës bujqësore.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

15.2. Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së zhvillimit, DPZHT Tepelenë të marrë masa për të vijuar me ndjekjen e fazave të tjera për aplikimin e lejes së ndërtimit dhe të mos miratojë deklarata paraprake për kryerjen e punimeve për objekte të cilat nuk përfshihen në këtë kategori aplikimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga DPZHT Tepelenë ndjekien me rigorozitet të hapave të parashikuar për gjatë shqyrtimit të aplikimeve për leje ndërtimi.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

16.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga DPZHT Tepelenë respektimin e distancave gjatë shqyrtimit të aplikimeve për leje ndërtimi. Evidentimi konkret i distancave do të shqyrtohet gjatë auditimit në raste të dhënies së lejeve të ndërtimit.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

17.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të shqyrtuar me vëmendje të dhënat e paraqitura në planvendosje, në mënyrë që të jenë në përputhje me projektin e ndërtimit dhe të përcaktohet saktë lartësia dhe numri i kateve të objektit.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga DPZHT Tepelenë respektimin e të dhënave të planvendosjes në projektin e ndërtimit. Evidentimi konkret do të shqyrtohet gjatë auditimit në raste të dhënies së lejeve të ndërtimit.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

18.1. Rekomandimi: Pas miratimit të lejes së ndërtimit DPZHT Tepelenë të marrë masa për të zhvilluar mbikëqyrjen e punimeve dhe verifikime në terren të ndërtimit të objektit, për të verifikuar mbajtjen e akteve të kontrollit dhe të mos lejojë përdorimin e objekti pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga DPZHT Tepelenë verifikime në terren për zbatimin e punimeve të objekteve për të cilat është dhënë leje ndërtimi. Evidentimi konkret do të shqyrtohet gjatë auditimit në raste të dhënies së lejeve të ndërtimit.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

18.2. Rekomandimi: Nga IVMT Tepelenë të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren dhe të verifikojnë në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e punimeve gjatë ndërtimit për objektet që janë pajisur me leje ndërtimi deri në përfundimin e punimeve të ndërtimit dhe moslejimin e përdorimit të objektit pa u pajisur me certifikatë përdorimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga DPZHT Tepelenë verifikime në terren për zbatimin e punimeve të objekteve për të

cilat është dhënë leje ndërtimi. Evidentimi konkret do të shqyrtohet gjatë auditimit në raste të dhënies së lejeve të ndërtimit.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

19.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit pa verifikuar më parë masën e ndryshimit të sipërfaqeve ndërtimore në projekt dhe duke verifikuar realizimin e zbatimit të punimeve në përputhje me projektin e ndërtimit të miratuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga DPZHT Tepelenë verifikime të hollësishme për masat e ndryshimit të sipërfaqeve ndërtimore në projektet në vijim. Evidentimi konkret do të shqyrtohet nëse do të ketë raste të ndryshimeve të sipërfaqeve ndërtimore në të ardhmen.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

20.1. Rekomandimi: Nga DPZHT Tepelenë të merren masa për të mos pajisur me çertifikatë përdorimi dhe miratuar leje ndërtimi pa konfirmuar më parë mënyrën e aksesit në parcelën që do të zhvillohet ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se me urdhër nr. 137, datë 18.10.2023, titullari i Bashkisë ka kërkuar nga DPZHT Tepelenë verifikime për mënyrën e aksesit në projektet në vijim. Evidentimi konkret do të shqyrtohet gjatë auditimit në raste të dhënies së lejeve të ndërtimit.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **në proces**.

21.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi i strukturës së njësisë vendore të mbrojtjes së territorit rezulton se në këtë njësi nuk janë kryer rekrutime të reja për pozicionin e inspektorëve.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pa zbatuar**.

22.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për të lidhur kontratat e punës me punonjësit përpara ushtrimit të detyrës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se në vijim nuk ka patur raste të përsëritura të kësaj shkelje. Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

23.1. Rekomandimi: Nga IVMT të merren masa për të zhvilluar kontrolle të vazhdueshme në terren për të konstatuar ndërtimet informale dhe ato që nuk janë në përputhje me lejet e ndërtimit të miratuara, duke marrë vendime për prishje dhe duke i ekzekutuar ato, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se kjo njësi ka vijuar rregullisht punë për evidentimin e rasteve me shkelje dhe janë mbajtur procesverbalet përkatëse, por nuk u konstatua dokumentim për vendime prishje.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **pjesërisht i zbatuar**.

24.1. Rekomandimi: Nga IVMT Tepelenë të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren dhe të evidentojë zhvillimin e ndërtimeve pa leje ndërtimi, duke marrë masat e nevojshme për ndërprerjen e punimeve pa u pajisur me leje ndërtimi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Komenti: Nga auditimi rezultoi se kjo njësi ka vijuar rregullisht punë për evidentimin e rasteve me shkelje sa i takon zhvillimit të territorit.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

25.1. Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkohet marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces.

Menjëherë

Komenti: Nga auditimi rezultoi se nga 15 masa të cilat janë rikërkuar për zbatim, 10 prej tyre janë zbatuar dhe 5 të tjerat janë në proces.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR PËR TË RRITUR PERFORMANCËN NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1.1.Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 188,311 lekë, e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Tepelenë, si pasojë e përlllogaritjes së pasaktë të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

Komenti: Nga auditimi rezulton se me shkresën nr. 988/19, datë 23.10.2023 subjekti E.Z është njoftuar për shlyerjen e vlerës së mësipërme, detyrim i cili është shlyer nga subjekti më datë 03.11.2023.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i zbatuar**.

C. MASA DISIPLINORE

C.1.Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr.

152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t’i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet për punonjësit:

1. Z. L.B., me detyrë Drejtor i DPKZHT Tepelenë, nga periudha 01.11.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

2. Znj. J.K., me detyrë Nënkyetare Bashkie/Drejtores e Drejtorisë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative (DLSHO), nga periudha 13.12.2004 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, si dhe për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Vërejtje për punonjësit:

1. Z. S.K., me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualit të auditimit të brendshëm” i miratuar me urdhërin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016; 135

2. Z. M.Sh., me pozicion Specialist Pyje Kullota Mbrojtje tokash, Ujitje Kullimit DZHR, nga periudha 10.07.2019 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin

nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”;

3. Znj. B.Xh., me pozicion specialiste Mjedisi DZHT, nga periudha 17.04.2017 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 1 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”;

4. Znj. Xh.P., me pozicion Specialiste Pyjesh, nga periudha 11.03.2019 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

C.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masat Disiplinore” dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Vërejtje për punonjësit:

1. Z. G.Sh., me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural (DZHR), nga periudha 06.04.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr.373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kritereve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, si dhe për mosmarrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të krijuara nga mospagesa nga 16 subjekteve të tarifave të qirave në vlerën 3,708,676 lekë, duke sjellë të ardhura të munguar për bashkinë, mangësi këto në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 136 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies

me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkatëse neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”;

2. Znj. Zh.M., me pozicion specialiste e jashtme, nga periudha 03.08.2020 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”;

3. Z. E.L., me pozicion Inspektor i IVMT Tepelenë, nga periudha 02.05.2018 e në vijim; për parregullsitë e konstatuara në 5 raste të zhvillimit të ndërtimeve në terren, të ndërtuara pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaratë për njoftim fillim punimesh pa u pajisur me certifikatë përdorimi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014;

4. Z. K.N., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për mangësi në zbatimin e përgjegjësi të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualit të auditimit të brendshëm” i miratuar me urdhërin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për mangësi në zbatimin e përgjegjësi të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016;

5. Z. G.G. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe

6. Z. R.H. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, Për mangësitë e konstatuara: - Mosplanifikim i të ardhurave mbi bazë reale, duke mos pasqyruar saktë bazën e tatueshme dhe burimin e të ardhurave, proces i cili sjell ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore - Për mos zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91,93,94 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe VKB nr. 74, datë 28.12.2018, e ndryshuar, për paketën fiskale, duke krijuar gjatë vitit 2022 vlerë debitorë prej 1,733,167 lekë për taksat dhe tarifave vendore, duke mos realizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore në vlerën 20,381,313 lekë në fund të vitit 2022. - Mos mbajtje të regjistrave të plotë, planifikim jo i saktë dhe mos marrje masash për arkëtim të taksës së ndërtesës e truallit dhe tarifave pastrim-ndriçim-gjelbërimit nga taksapaguesit të kategorisë “Familjar” dhe mos identifikimi i plotë i familjeve, që kanë detyrim për këto taksat e tarifa, pa llogaritur detyrimin e pa derdhur Bashkisë prej 16,397,158 lekë deri në fund të vitit 2022 për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, mangësi këto në kundërshtim me VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë” i 137 ndryshuar, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat

e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me Ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me Ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117. - Për mosdisponim të dhënash të plota dhe të sakta për planifikimin e taksës bujqësore mbi baza reale, ku familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore, pasi Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve, që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore, që familjet zotërojnë në përdorim dhe me AMTP, mangësi këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, Aneksi 1 dhe me VKB nr. 74 datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore” i ndryshuar pika 4/4. - Për mos marrjen e masave për arkëtimin e vlerës debitorë progresive prej 2,078,937 lekë, të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet deri në fund të vitit 2022.

7. Z. H.Z., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, Mbrojtjes së Tokës dhe Ujrave, për mosmarrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të krijuara nga mospagesa nga 16 subjekteve të tarifave të qirave në vlerën 3,708,676 lekë, duke sjellë të ardhura të munguar për bashkinë, mangësi këto në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.2006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkatëse neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”.

Koment: Nga auditimi rezultoi se nuk janë marrë masa për ngritjen e një komisioni apo vlerësimin nga titullari për vendosjen e masave disiplinore të rekomanduara.

Për sa më lart rekomandimi konsiderohet **i pa zbatuar**.

III. GJETJE DHE REKOMANDIME

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dhe analizimi i komponentëve të MFK-së u konstatuan:

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. Nuk ka dokument, që vërteton se ka ndjekur realizimin e objektivave të veprimtarisë së Bashkisë, me vendime për zbutjen e ndikimit në një nivel të pranueshëm dhe mënjanimin e riskut.

Nuk është ngritur grupi i punës së riskut, mungesa e të cilëve e për pasojë dhe mungesës së veprimtarisë së tij, ka sjellë mos identifikimin e vlerësimin e të gjitha risqeve të mundshme në të gjithë sistemet e kontrollit të brendshëm. Nuk ka një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) apo për ruajtjen e tij, pra nuk ka një plan menaxhimi të riskut të IT për rikuperimin e të dhënave në raste fatkeqësish. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në faqet 9-22 të Raportit).

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Tepelenë, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosjen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se struktura e Njësisë së Auditimit të Brendshëm nuk është e plotë, pasi aktualisht funksionon me një auditues/përgjegjës sektori., Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga NJAB u konstatua se nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit në këtë bashki gjithashtu nga përgjegjësi i këtij sektori nuk është kryer zbatimi i rekoamandimeve për 6-mujorin paraardhës nga sektori i Auditit të Brendshëm, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe “Manuali i auditimit të brendshëm në sektorin publik”; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 9-22 të Raportit).*

2.1 Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, të marrë masa për kryerjen e zbatimit të rekomandimeve për 6-mujorin paraardhës të lëna nga NJAB.Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Bashkia Tepelene ka patur detyrime të prapambetura në fillim të vitit në vlerën 26,173,384 lekë. Gjatë vitit 2023 janë krijuar detyrime në vlerën 16,879,996 lekë ndërkohë që janë shlyer në vlerën 9,179,187 lekë, duke rezultuar në një detyrim progresiv në fund të 2023 në vlerën 33,874,193 lekë, e cila do të rëndojë në buxhetin e vitit 2024 krahas likuidimeve të radhës. Nga vlerësimi i detyrimeve të prapambetura të Bashkisë përkundrejt shpenzimeve faktike të vitit prej 273,053,170 lekë, rezulton se Bashkia Tepelenë gjendet në situatë normale financiare në treguesin prej 12.5%. Detyrimet e prapambetura të pa likuiduara përbëhen nga këto zëra analitikë, sa vijon:

-vlera 5,528,329 lekë, investime nga Bashkia.

-vlera 28.222.865 lekë, mallra dhe shërbime.

-vlera 122.999 lekë, vendime gjyqësore. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 22-41 të Raportit).*

3.1 Rekomandimi: Bashkia Tepelenë për vitin 2024 të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura në vlerën 33,874,193 lekë sipas metodës FIFO dhe duke aplikuar një balancë mes kufizimit të shpenzimeve dhe shlyerjes së detyrimeve, përkatësisht 5,528,329 lekë të investimeve nga Bashkia, 28.222.865 lekë nga mallrat dhe shërbimet, 122.999 lekë të vendimeve gjyqësore, duke marrë këto masa: reduktimin e shpenzimeve, rritjen e të ardhurave vendore, mbledhjen e arkëtimit e debitorëve, kërkimin e çeljes së fondeve nga qendra sipas burimit financimit të investimeve të kryera.

Brenda vitit 2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në gjendjen prej 153,584,876 lekë të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2023 nuk është përfshirë vlera pjesore prej 2,785,790 lekë e pa derdhur nga Ujësjellës-Kanalizime e taksave dhe tarifave vendore të mbledhura nga taksapaguesit si detyrim i vitit 2023, pasi ka ardhur shkresa e konfirmim/rakordimit

në vitin 2024 pas mbylljes të veprimeve kontabël të vitit ushtrimor. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kreu III, pika 32, Aneksi 1, pika 3.3. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 41-60 të Raportit).*

4.1 Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

Deri me datë 31.03.2025

5. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*” në aktiv të bilancit në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 352,003 lekë dhe me kosto historike në vlerën 352,003 lekë. Kjo llogari i përket projektit “Studim, mbyllja, rehabilitimi i mbetjeve urbane nga vend-depozitimet ilegale” vlerë e shtuar gjatë vitit 2022, për të cilën nuk është llogaritur amortizim në masën 15% në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Kreu III, pika 36. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 41-60 të Raportit).*

5.1. Rekomandim: Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar në Bashkinë Tepelenë të bëjë korrektime të duhura për llogaritjen e amortizimit të aktiveve afatgjata jo materiale dhe të kryejë sistemimet e kontabël përkatëse në llogarinë 202 “*Studime dhe kërkime*”.

Deri me datë 31.03.2025

6. Gjetje nga auditimi: Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2023 me urdhër-shpenzime në 50 raste faturash me vlerë 43,646,548 lekë, mbi afatin e miratuar 30 ditor të pagesave nga data e faturave për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Tepelenë, ku 48 raste në vlerën 20,846,548 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 “shpenzime operative” dhe në 2 raste në vlerën 22,800,00 lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 “investime”, ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Likuidimi me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 41-60 të Raportit).*

6.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përgjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Menjëherë dhe në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se Bashkia Tepelenë zotëron në total 2308 asete të kaluara në pronësi me VKM. Nga këto, Bashkia Tepelenë ka marrë masa dhe ka regjistruar e pajisur me certifikatë në ZVRPP Tepelenë 214 asete me sipërfaqe 1,007 ha tokë të llojit pyje, kullota e ara, të cilat janë kontabilizuar në vlerën prej 1,161,383,237 lekë. Ndërkohë që janë marra masa dhe është aplikuar pranë DVASHK për regjistrimin e 83 aseteve të tjera. Nga auditimi

konstatohet se veprimet e mësipërme janë kryer vetëm asete të llojit troje, kullota, ara, etj, dhe nuk konstatohet të jenë kryer aplikime apo regjistrime për asetet e llojit objekte. Gjithashtu konstatohet se për të gjitha asetet që i kanë kaluar në pronësi, Bashkia nuk ka kryer një inventarizim periodik, duke mos patur informacion as për gjendjen e tyre që pas kalimit në pronësi, nëse janë ende ekzistente apo të dëmtuara, të zaptuara rishtazi, privatizuara, etj. Po kështu sa i takon aseteteve të llojeve kullota/pyje transferuar sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, rezulton se Bashkisë Tepelenë i janë transferuar asete gjithsej 29’340 ha, nga të cilat 8’950 ha Pyje, 19’989 ha Kullotë dhe 401 ha Toka joproductive. Nga sipërfaqet e mësipërme rezulton se janë rregjistruar në AShK Tepelenë rreth 29’000 ha. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” nenin 18, të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, pikën 18, 22, me ligjin nr.20/2020, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu IV “Përditësimi, inventarizimi, transferimi dhe regjistrimi i pronave të paluajtshme publike”nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”dhe VKM-së nr.669, datë 07.08.2013 ”Për miratimin e rregullave për përcaktimin, krijimin dhe realizimin e kornizës referuese gjeodezike shqiptare (KRGJSH)”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 60-72 të Raportit).*

7.1.Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Tepelenë të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes së aseteteve të mbetura pa regjistruar të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH me shkresë nr. 422/8 prot., datë 28.09.2023, rezultoi se Bashkia Tepelenë ka respektuar afatet 20 ditore dhe 6 mujore të dërgimit të planit të masave dhe relacionit mbi zbatimin e rekomandimeve, dërguar në KLSH përkatësisht me shkresën nr. 2004/3, datë 18.10.2023 për planin e veprimit dhe shkresën nr. 449, datë 29.02.2024 për raportimin mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve. Sa i takon auditimit të kryer për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, rezultoi se nga KLSH janë lënë gjithsej 41 masa, të cilat janë pranuar plotësisht ose në masën 100%. Nga 41 masat e rekomanduara janë zbatuar plotësisht 10 prej tyre ose 24.4%, janë në proces zbatimi 13 masa ose 31.7%, pjesërisht zbatuar 3 masa dhe pa zbatuar rezultuan 15 masa ose 36.5%. Më konkretisht, për përmirësimin e gjendjes janë lënë 27 masa organizative nga të cilat, 9 janë zbatuar plotësisht, 13 masa në proces zbatimi, 3 masa janë zbatuar pjesërisht dhe 2 nuk janë zbatuar. Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara), 1 masë në vlerën 188,311 lekë e pranuar dhe e zbatuar. Ndërkohë nga 13 masa disiplinore për punonjësit, nuk janë marrë masa për zbatimin e tyre, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 72-84 të Raportit).*

8.1.Rekomandimi: Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju

rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përshpejtimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

A. Masa Organizative

2.1. Rekomandimi: Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm të merren masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse t'i jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Nga kryetari i Bashkisë Tepelenë, të merren masa për të plotësuar strukturën e sektorit të auditimit të brendshëm.

Në vijimësi

6.1. Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë, të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve që kanë në pronësi tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve, referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Tepelenë.

Menjëherë dhe në vijimësi

9.1. Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të shqyrtojë dokumentacionin e subjektit B. ShPK dhe të marrë masa që ky subjekt të pajiset menjëherë me autorizimin/licencën për ushtrimin e aktivitetit, duke paguar vlerën e mbetur prej 1,000,000 lekë ndaj Bashkisë Tepelenë për 5 vjet, që nga data e mbarimit në vitin 2022. Gjithashtu, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të ndjekë rregullisht pagesat periodike dhe të prapambetura të autorizimeve për të gjithë subjektet: B. Shpk në vlerën 100,000 lekë, O. Shpk në vlerën 380,000 lekë dhe S.G. Shpk në vlerën 800,000 lekë, me qëllim që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

21.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Tepelenë të merren masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës inspektor në Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

23.1. Rekomandimi: Nga IVMT të merren masa për të zhvilluar kontrole të vazhdueshme në terren për të konstatuar ndërtimet informale dhe ato që nuk janë në përputhje me lejet e ndërtimit të miratuara, duke marrë vendime për prishje dhe duke i ekzekutuar ato, në bazë të legjislacionit në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE

C.1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 58 “Llojet e masave disiplinore”, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, t'i kërkojë komisionit disiplinor fillimin e procedurave për dhënien e masave disiplinore si më poshtë:

Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet për punonjësit:

1. Z. L.B., me detyrë Drejtor i DPKZHT Tepelenë, nga periudha 01.11.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

2. Znj. J.K., me detyrë Nënkrjetare Bashkie/Drejtores e Drejtorisë Ligjore dhe Shërbimeve Organizative (DLSHO), nga periudha 13.12.2004 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, si dhe për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Vërejtje për punonjësit:

1. Z. S.K., me detyrë Drejtor i Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financiar, për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualit të auditimit të brendshëm” i miratuar me urdhërin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016; 135

2. Z. M.Sh., me pozicion Specialist Pyje Kullota Mbrojtje tokash, Ujitje Kullimit DZHR, nga periudha 10.07.2019 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”;

3. Znj. B.Xh., me pozicion specialiste Mjedisi DZHT, nga periudha 17.04.2017 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 1 rast të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar;

me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”;

4. Znj. Xh.P., me pozicion Specialiste Pyjesh, nga periudha 11.03.2019 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”.

C.2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës apo me status të parashikuar në ligje të veçanta:

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 “Masat Disiplinore” dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tepelenë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

Vërejtje për punonjësit:

1. Z. G.Sh., me pozicion Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Rural (DZHR), nga periudha 06.04.2016 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr.373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”, si dhe për mosmarrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të krijuara nga mospagesa nga 16 subjekteve të tarifave të qirave në vlerën 3,708,676 lekë, duke sjellë të ardhura të munguar për bashkinë, mangësi këto në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 136 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkatëse neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”;

2. Znj. Zh.M., me pozicion specialiste e jashtme, nga periudha 03.08.2020 e në vijim, për parregullsitë e konstatuara në 1 rast të miratimit të lejes së zhvillimit, në 2 raste të miratimit të lejeve të ndërtimit, në 2 raste të miratimit të certifikatave të përdorimit dhe në 1 rast për miratimin e deklaratës paraprake, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; me VKM-në 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar; me Ligjin nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar; me VKM-në nr. 373, datë 20.6.2018, “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënien me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit”; me Ligjin nr. 57/2020, datë 30.4.2020, “Për pyjet”;

3. Z. E.L., me pozicion Inspektor i IVMT Tepelenë, nga periudha 02.05.2018 e në vijim; për parregullsitë e konstatuara në 5 raste të zhvillimit të ndërtimeve në terren, të ndërtuara pa u pajisur me leje ndërtimi, pa deklaratë për njoftim fillim punimesh pa u pajisur me certifikatë përdorimi, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014;

4. Z. K.N., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Auditit të Brendshëm, për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 datë 06.11.2015 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, “Manualit të auditimit të brendshëm” i miratuar me urdhërin e ministrit të financave me nr. 100, datë 25.10.2016 “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”. Për mangësi në zbatimin e përgjegjësive të detyrës funksionale në lidhje me kërkesat e Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016;

5. Z. G.G. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe

6. Z. R.H. me detyrë Inspektor në Sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore, Për mangësitë e konstatuara: - Mosplanifikim i të ardhurave mbi bazë reale, duke mos pasqyruar saktë bazën e tatueshme dhe burimin e të ardhurave, proces i cili sjell ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore - Për mos zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet 89, 90, 91,93,94 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe VKB nr. 74, datë 28.12.2018, e ndryshuar, për paketën fiskale, duke krijuar gjatë vitit 2022 vlerë debitorë prej 1,733,167 lekë për taksat dhe tarifa vendore, duke mos realizuar mbledhjen e detyrimeve tatimore në vlerën 20,381,313 lekë në fund të vitit 2022. - Mos mbajtje të regjistrave të plotë, planifikim jo i saktë dhe mos marrje masash për arkëtim të taksës së ndërtesës e truallit dhe tarifave pastrim-ndriçim-gjelbërimit nga taksapaguesit të kategorisë “Familjar” dhe mos identifikimi i plotë i familjeve, që kanë detyrim për këto taksat dhe tarifa, pa llogaritur detyrimin e pa derdhur Bashkisë prej 16,397,158 lekë deri në fund të vitit 2022 për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, mangësi këto në kundërshtim me VKB nr. 74, datë 28.12.2018, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Tepelenë” i 137 ndryshuar, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me Ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me Ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117. - Për mosdisponim të dhënash të plota dhe të sakta për planifikimin e taksës bujqësore mbi baza reale, ku familjet nuk ngarkohen për pagesën e taksës së tokës bujqësore, pasi Sektori i Tatimeve nuk ka asnjë informacion lidhur me numrin e familjeve, që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore, që familjet zotërojnë në përdorim dhe me AMTP, mangësi këto në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika 1, Aneksi 1 dhe me VKB nr. 74 datë 28.12.2018 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore” i ndryshuar pika 4/4. - Për mos marrjen e masave për arkëtimin e vlerës debitorë progresive prej 2,078,937 lekë, të taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet deri në fund të vitit 2022.

7. Z. H.Z., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave, Mbrojtjes së Tokës dhe Ujrave, për mosmarrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore të krijuara nga mospagesa nga 16 subjekteve të tarifave të qirave në vlerën 3,708,676 lekë, duke sjellë të ardhura të munguar për bashkinë, mangësi këto në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkatëse neni 5 “Pagesa e tarifës së qirasë”.

B. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga pagesat që kryhen nga qytetarët që përfitojnë certifikatën e pronësisë në përfundim të procesit të legalizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë rezulton se për vitin 2023 nga 13 objekte të legalizuara me vlerë 278,190 lekë kanë paguar detyrimin 10 subjekte me vlerë 240,278 lekë dhe nuk kanë paguar 3 qytetarë me vlerë 37,912 lekë. Ndërsa nga vitet e mëparshme janë 58 debitorë në vlerë totale 2,059,646 lekë, gjithsej 61 debitorë në vlerë totale 2,097,558 lekë, që përbën detyrim për arkëtim në buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3.c dhe VKM-së nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtime pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5. Pika 5 e nenit 27 të ligjit 9632 datë 30.10.2006 “për sistemin e taksave dhe tarifave vendore”. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 22-41 të Raportit).*

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të dërgojë periodikisht informacion në Sektorin e Tatim taksave mbi subjektet debitorë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet” dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtime që janë legalizuar me vlerë 2,097,558 lekë.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Tepelenë nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifën e tjera të miratuara me Vendim të Këshillit Bashkiak, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Sektori Tatim Taksave regjistron vetëm të dhëna lidhur me familjet që paguajnë ndërsa për familjet debitorë nuk ka një regjistër.

Si rezultat, procesi i ngarkimit të familjeve për detyrimet vendore nuk është i dokumentuar si dhe nuk dihet numri i familjeve debitorë dhe vlera totale që ato kanë ndaj bashkisë. Gjendja e debitorëve progresiv të vitit 2022 është 20,381,318 lekë dhe në fund të vitit 2023 vlera debitorëve është 22,233,772 lekë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet e VKB-në nr. 92, datë 25.11.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë”, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e

vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 22-41 të Raportit).*

2.1.Rekomandimi: Sektori i Tatim Taksave në Bashkinë Tepelenë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të vitit 2023 në vlerën progresive **22,233,772 lekë** e përbërë nga:

- Detyrimet nga taksat dhe tarifave për 184 subjekte biznesi i vogël në shumën 599,060 lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifave për 49 subjekte biznesi i madh në shumën 11,536,571 lekë;
- Detyrime nga 6 institucione në shumën 769,648 lekë;
- Detyrime nga Kryefamiljarë të pajisur me leje legalizimi në 3 raste në shumën 10,313,690 lekë;
- Detyrime nga NJ.A. Qendër në shumën 9,328,493 lekë.

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e-Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Tepelenë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Tepelenë aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës. Sektori i Tatimeve nuk ka të dhëna lidhur me numrin e familjeve që kanë detyrimin për të paguar tarifën e pastrimit dhe taksën e ndërtesës, nuk ka të dhëna lidhur me nivelet e pritshmërisë së tyre si dhe nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve, që janë debitorë ndaj bashkisë. Gjithashtu, familjet në Bashkinë Tepelenë nuk ngarkohen për detyrimet vendore për taksat dhe tarifave të tjera të miratuara me VKB, si për shembull taksa e tokës bujqësore, taksa e truallit, tarifën e gjelbërimit. Bashkia Tepelenë ka si Agjent Tatimor për arkëtimin tarifës së pastrimit dhe taksën e ndërtesës Sha Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, e cila sipas aktrakordimit me Bashkinë Tepelenë për të ardhurat rezulton se deri në fund të vitit 2022 ka mbetur pa u derdhur Bashkisë vlera në mënyrë progresive prej 16,397,158 lekë, që përbën detyrim për arkëtim në buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 92, datë 25.11.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë”, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 22-41 të Raportit).*

3.1.Rekomandimi: Bashkia Tepelenë nëpërmjet Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe NJA, të marrë masa për krijimin e regjistratit të taksave dhe tarifave vendore për taksapaguesit e

kategorisë “familjare” me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të Bashkisë Tepelenë. Bashkia Tepelenë, bazuar në kontratën dypalëshe me agentin tatimor UK Tepelenë SHA, të kërkojë prej këtij të fundit xhirimin e vlerës 16,397,158 lekë, në llogarinë përkatëse në degën e thesarit.

Menjëherë dhe në vijimësi

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFIÇENCË DHE EFEKTIVITET TË TYRE – TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Bashkia Tepelenë ka si Agjent Tatimor për arkëtimin tarifës së pastrimit dhe taksën e ndërtesës Sha Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, e cila sipas aktrakordimit me Bashkinë Tepelenë rezulton se për vitin 2023 dhe muajt Tetor - Dhjetor 2022 debia e taksave familjare është 2,785,790 lekë që përbën të ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Tepelenë, të cilat nuk janë pasqyruar në bilancin e vitit 2023, pasi rakordimi është bërë në vitin 2024 dhe bilanci ishte mbyllur. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 92, datë 25.11.2022, “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Tepelenë”, me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7, me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 22-41 të Raportit të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Bashkia Tepelenë Sektorit të Tatim Taksave në bashkëpunim me Drejtorinë së Financës të marrin masa të kontabilizojnë detyrimin e krijuar nga Sha Ujësjellës-Kanalizime Tepelenë, si dhe bazuar në kontratën dypalëshe me agentin tatimor UK Tepelenë SHA, të kërkojë prej këtij të fundit xhirimin e vlerës 2,785,790 lekë për vitin 2023, në llogarinë përkatëse në degën e thesarit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga informacioni dhe dokumentacioni që bashkia disponon, rezultojnë 6 subjekte që ushtrojnë aktivitet tregtim lëndë djegëse me pakicë, të 6 subjektet kanë detyrime me një efekt financiar me vlerë totale 3,750,000 lekë e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Tepelenë. Këto veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar me ligjin nr. 71.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4. *(Më hollësisht trajtuar në faqet 22-41 të Raportit të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Bashkia Tepelenë, Sektori i Tatim Taksave të marrë masa që subjektet të plotësojnë dokumentacionin të bëjnë pagesën përkatës për ushtrimin e aktivitetit duke paguar detyrimet ndaj Bashkisë Tepelenë me vlerë 3,750,000 lekë. Gjithashtu, Sektori i Tatim Taksave të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet me qëllim që të kryhen pagesat e plota brenda afateve.

Menjëherë dhe në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Tepelenë**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

Grupi i auditimit

R. K., përgjegjës grupi

I. Sh., anëtare

E. K., anëtare

K. F., anëtare

Drejtori i Departamentit

J. T.